



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 510 Akti

Nr. 326 Vendimi  
Tiranë, më 17.12.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Xhensila Pine</b>	Kryesues
<b>Olsi Komici</b>	Relator
<b>Firdes Shuli</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 17.12.2020, ora 15:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Florjan Kalaja**, aktualisht gjyqtar i komanduar në Gjykatën e Apelit Durrës, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Olsi Komici, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore publike në tërësinë e tij vlerësimin kalimtar ndaj subjektit Florjan Kalaja, i cili kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, ushtron detyrën e gjyqtarit të komanduar pranë Gjykatës së Apelit Durrës dhe në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.6.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, short nga i cili rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Olsi Komici.
3. Me vendimin nr. 1, datë 22.6.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Florjan Kalaja, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Xhensila Pine. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Branko Hrvatin.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim, Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, DSIK) dhe Grupi i Punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
5. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit është kryer bazuar në një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 26.11.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 26.11.2020, mbi përbërjen e trupit gjykues, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/sqarime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht i zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
8. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit në datën 7.12.2020, ka dërguar nëpërmjet postës elektronike dhe dorazi prapësimet, si dhe provat për rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

9. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë në rrugë elektronike në datën 11.12.2020.

10. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 16.12.2020, ora 15:00, në sallën e konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

11. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, parashtrori shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit z. Florjan Kalaja, kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

12. Z. Florjan Kalaja ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, si dhe ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

13. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. Për subjektin e rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit përfshin të tria kriteret: (1) vlerësimin e pasurisë; (2) kontrollin e figurës; dhe (3) vlerësimin e aftësive profesionale.

15. Pavarësisht se në kreun IV të ligjit nr. 84/2016 2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të kryer vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me këtë vlerësim pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetues dhe kreut II të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

#### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

16. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2019, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, i cili është subjekt deklarues në ILDKPKI që prej vitit 2010, me numër indeksi \*\*\*, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa

nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

**17.** Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2010 deri në 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë - shtojca 2, në datën 23.1.2017. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për çdo pasuri të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*

## **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

21. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të kontrollit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Referuar neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- b) deklaratën e pasurisë - shtojca 2 dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite;
- c) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet, të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016 si nga: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Banka e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë, drejtoritë vendore të Kadastrës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, drejtoritë rajonale të tatimeve, Qendra Kombëtare e Biznesit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., shoqëria “Ujësjellës-Kanalizime” sh.a., zyra noteriale, DRSSH-të etj.;
- e) deklarime dhe prova të dërguara nga subjekti i rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- f) shpjegimet me shkrim të subjektit, si dhe shpjegimet në seancën dëgjimore.

**18.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

**19.** Në lidhje me dorëzimin e deklaratës së pasurisë - shtojca 2, në zbatim të nenit 31/1<sup>1</sup>, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë

---

<sup>1</sup> Subjekti i rivlerësimit ka detyrim të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

edhe personat e lidhur me të), në bazë të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.1.2017, brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Pasuritë e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë - shtojca 2.

**1. Automjet tip “BMW” seria 3, 320, viti prodhimit 2005, blerë në datën 18.3.2015, sipas kontratës noteriale në shumën 5,600 euro. Detyrimi është shlyer ditën e nënshkrimit të kontratës. Pjesa takuese: 100%.**

**Burimi i krijimit:** kursime nga paga si gjyqtar dhe pedagog; overdraft; karta e kreditit; të ardhura nga shitja e librave.

### **Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni**

**1.1.** Në deklaratën periodike (DIPP në vijim) të vitit 2014 subjekti ka deklaruar: *“Makinë BMW, seria 3, 320, viti 2005, me vlerë 5,600 euro me pjesë takuese 100%. (në proces regjistrimi në regjistrat publik pasi është e sapo blerë). Burimi i krijimit të të ardhurave: (i) kredia e overdraftit 200,000 lekë; (ii) të ardhura nga shitja e librit 200,000 lekë; (iii) kursime nga paga dhe puna si pedagog” të shprehura këto të ardhura me fjalë “shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë”.*

Në DIPP të vitit 2015 subjekti ka deklaruar: *“Makinë BMW, seria 3, 320, viti 2005 e blerë në datën 18.3.2015, sipas kontratës së kryer para noterit ku detyrimi është shlyer ditën e nënshkrimit të kontratës. Vlera 5,600 euro, me pjesë takuese 100%”.*

**1.2.** Subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes<sup>2</sup>, datë 18.3.2015, me shitës shtetasin A.Xh., (i përfaqësuar me prokurë nga F.Xh.) dhe blerës shtetasin Florjan Kalaja për automjetin “BMW VC31”, viti 2005, me çmimin 5,600 euro, paguar jashtë zyrës noteriale.

**1.3** DPSHTRr-ja<sup>3</sup> konfirmon regjistrimin në emër të z. Florjan Kalaja të automjetit “BMW” seria “320D”, viti 2005, me targa \*\*\*, i përfituar nga kontrata e shitjes, datë 18.3.2015, si më sipër, me çmimin 5,600 euro. Nga dokumenti doganor, datë 28.10.2014, rezulton që taksa doganore në shumën 163,096 lekë, është paguar nga shtetasi A.Xh.

**1.4.** Komisioni ka hetuar mbi ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasit A., dhe F.Xh., dhe nga korrespondenca e kryer me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>4</sup> nuk u konstatua ndonjë situatë e tillë.

**Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë të automjetit tip “BMW” në përputhje me dokumentacionin e depozituar nga subjekti dhe nga DPSHTRr-ja.**

**1.5. Analizë financiare e burimit të krijimit të automjetit tip “BMW”, blerë në shumën 5,600 euro.**

**1.5.1. Burimi i parë – kursime nga paga si gjyqtar dhe pedagog**

<sup>2</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.3.2015.

<sup>3</sup> DPSHTRr-ja me nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2020.

<sup>4</sup> Gjykata e Rrethit Vlorë me nr. \*\*\* prot, datë 23.11.2020.

Nga verifikimi i pasqyrës së llogarisë bankare të pagës në “Tirana Bank”<sup>5</sup>, rezulton se për periudhën nga 1 janar i vitit 2015 deri në datën e blerjes së automjetit më 18.3.2015, subjekti ka përfituar paga në shumën 264,743 lekë.

Gjatë kësaj periudhe subjekti ka përfituar edhe të ardhura nga puna si pedagog në shumën 98,100 lekë, e transferuar kjo në llogarinë e tij bankare në BKT<sup>6</sup> nga Universiteti “Pavarësia”, Vlorë dhe tërhequr nga subjekti në datën 10.3.2015.

### **1.5.2. Burimi i dytë – overdraft me limit 200,000 lekë, në “Tirana Bank”**

Subjekti deklaroi në DIPP-në e vitit 2013 dhe 2014: “Kontratë kredie në llogarinë rrjedhëse (overdraft) nr. \*\*\* /14.10.2013, deri në akumulimin e tepicës debitoare të mbitërheqjes në shumën 200,000 lekë”.

**1.5.2.1.** Referuar pasqyrës së llogarisë bankare në “Tirana Bank” rezulton se në datën 14.10.2013, subjekti ka tërhequr nga llogaria bankare shumën 207,000 lekë me përshkrimin “tërheqja e overdraftit”.

**1.5.2.3.** Gjatë periudhës 1.1.2015 – 18.3.2015, në këtë llogari janë kredituar: (i) pagat e subjektit si gjyqtar në shumën 264,743 lekë; (ii) shuma prej 6,800 lekësh si honorar nga revista “Avokatia”; si dhe (iii) janë depozituar *cash* në dy transaksione shuma prej 84,000 lekësh duke rezultuar në datën 18.3.2015 me një gjendje në llogari në shumën -80,097.08 lekë.

Në datën 19.3.2015, subjekti ka tërhequr nga llogaria bankare shumën 119,700 lekë duke përdorur në këtë mënyrë limitin total të overdraftit. Si burim për këtë shumë të tërhequr kanë shërbyer kryesisht të ardhurat nga pagat, të cilat janë trajtuar në pikën (a). Kjo shumë është tërhequr pas datës 18.3.2015, datë në të cilën sipas deklaramit të subjektit në deklaratën *Vetting* është bërë likuidimi i mjetit.

### **1.5.3. Burimi i tretë – karta e kreditit “Visa”, në Tirana Bank me limit 100,000 lekë**

Subjekti ka depozituar kontratë kredie për lëshim kartë krediti “Visa”, në “Tirana Bank”, në datën 16.10.2012, me limit 100,000 lekë me afat 12 muaj (karta e parë), me ripërtëritje automatike me vlefshmëri 24 muaj.

Nga pasqyra e llogarisë së kartës së kreditit rezulton se për periudhën nga 1 janari 2015 deri në e pagesës së automjetit, datë 18.3.2015, subjekti nuk ka kryer tërheqje nga karta e kreditit.

### **1.5.4. Burimi i katërt – të ardhura nga shitja e librave të botuara**

**1.5.4.1.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si një nga burimet për blerjen e automjetit të ardhurat e krijuara nga shitja e librave për të cilat ka autorësinë e tij (trajtuar në pikën 5 të vendimit). Subjekti nuk ka provuar pagesën e tatimit për të ardhurat e përfituara nga shitja e librave, si dhe për të ardhurat e deklaruara në vitin 2014 nuk ka deklaruar kursime *cash* për vitin 2014.

Në përfundim të analizës për secilin burim krijimi për blerjen e automjetit, subjekti rezulton me mungesë burimesh në shumën **590,198 lekë**.

	<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera në lekë</b>
<b>A</b>	<b>Të ardhurat</b>	<b>188,994</b>

<sup>5</sup> “Tirana Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 5.8.2020.

<sup>6</sup> BKT-ja me nr. \*\*\* prot., datë 20.8.2020.

1	Likuiditete ( <i>cash</i> +bankë) 1.1.2015	-180,649
2	Të ardhura nga paga e subjektit 1.1.2015 – 18.3.2015 <sup>7</sup>	369,643
3	Të ardhura nga shitja e librave	0
<b>B</b>	<b>Pasuri</b>	<b>704,003</b>
1	Automjet tip “BMW” blerë, datë 18.3.2015	784,000
	Likuiditete ( <i>cash</i> +bankë), datë 18.3.2015	-79,997
<b>C</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>75,189</b>
1	Shpenzime jetike 1.1.2015 – 18.3.2015	46,724
2	Shpenzime <i>TIMS</i>	13,765
3	Shpenzime qiraje	14,700
	<b>Mundësia financiare në momentin e blerjes së mjetit (A-B-C)</b>	<b>-590,198</b>

**1.6. Komisioni në lidhje me këtë pasuri referuar deklarimit ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 590,198 lekë për blerjen e mjetit në datën 18.3.2015.**

**1.7.** Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, pas kalimit të barrës së provës me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti në përgjigjet e tij shpjegon se kjo ka ardhur për shkak se nuk ka kuptuar saktë se në ç’rubrikë duhej të deklaronte kursimet në deklaratat e pasurisë dhe se me deklarimin e çdo burimi krijimi të të ardhurave ka shteruar detyrimin për deklarim. Gjithashtu, subjekti shpjegon se një gabim tjetër material në lidhje me plotësimin e deklaratave vjetore të pasurisë është deklarimi i të ardhurave dhe shpenzimeve deri në momentin e plotësimit të deklaratës (mars i vitit pasardhës) dhe jo deri në 31 dhjetor të vitit për të cilin bëhet deklarimi. Subjekti ka shpjeguar se të ardhurat për blerjen e automjetit janë krijuar duke përdorur të gjitha burimet e të ardhurave gjatë vitit 2014 dhe fillimit të vitit 2015, gjithashtu, edhe të ardhurat e së fejuarës.

#### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

**1.8.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse duke mos arsyetuar mungesën e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e automjetit, pasi në deklaratën e interesave private periodike/vjetore të pasurisë përcaktohet qartë periudha e deklarimit të likuiditeteve, detyrimeve, etj., nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit, ç’ka do të thotë, veprimet e kryera nga subjekti nga 1 janari i vitit përkatës deri në 31 dhjetor të po atij viti.

Të ardhurat e të fejuarës nuk janë marrë në konsideratë në këtë investim për arsye se subjekti ka deklaruar bashkëjetesën duke filluar nga muaji korrik i vitit 2015, ndërkohë që automjeti rezultoi të jetë blerë në mars të vitit 2015.

**Komisioni vlerëson se pasaktësitë në deklarim që kanë të bëjnë me periudhën dhe rubrikën e deklarimit të kursimeve në *cash* janë pasaktësi të paqëllimshme nga subjekti i rivlerësimit.**

<sup>7</sup> Kjo vlerë është rezultat i shumatores së pagave në “Raiffeisen Bank” prej 264,743 lekësh, shumës prej 6,800 lekësh të përfutur nga shkrimi në revistën “A.” dhe shumës 98,100 lekë të përfutur nga puna si pedagog dhe të tërhequra në BKT.

Subjekti i rivlerësimit, në datën 18.3.2015, ka rezultuar me mungesë burimesh financiare të ligjshme në shumën 590,198 lekë për blerjen e automjetit tip “BMW”, por në bazë të parimit të proporcionalitetit, si dhe marrë për bazë balancën financiare pozitive të subjektit për vitet 2014 dhe 2015, kjo nuk përbën shkak të mjaftueshëm për dhënie e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

**2. Në lidhje me shtëpitë e marrë me qira nga subjekti i rivlerësimit deklaruar prej tij në deklaratën *Vetting***

**2.1. Apartament 2+1, k. \*\*\*, deri në mars të vitit 2015, me qira mujore 20,000 lekë/muaj**

**2.1.1.** Në rubrikën e detyrime subjekti ka deklaruar: kontratë qiraje nga data 8.1.2015 – 8.3.2015, bashkë me një koleg, me vlerë 10,000 lekë secili/muaj.

**2.1.2.** Gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar: “... pronarin e apartamentit nuk e kemi njohur. Marrëveshja ndërmjet nesh si qiramarrës dhe qiradhënës është konkluduar verbalisht me një përfaqësues që pronari kishte lënë në Shqipëri që të administronte apartamentin. Përfaqësuesi është z. B.B., dhe ishte banor fqinj pranë pallatit ku ne banonim. Kjo marrëdhënie qiraje ka zgjatur nga ditët e para të janarit 2012 deri në muajin mars 2015. Qiraja mujore gjatë kësaj kohe ka qenë 20,000 lekë/muaj ...”.

**2.1.3.** Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale të datës 7.7.2020<sup>8</sup> me deklarues shtetasin B.B., i cili konfirmon se në janar të vitit 2012 është rënë dakord verbalisht që të japë shtëpinë në pronësi të kunatit z. I.A., të qiramarrësit Florjan Kalaja dhe L.F. Shuma e qirasë ka qenë 20,000 lekë/muaj dhe parapaguhej çdo fillim muaji.

**2.2 Apartament 2+1, pallat i ri, lagjja “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, k. \*\*\*, Vlorë, deri më 14.11.2016, me qira mujore 15,000 lekë/muaj. Burim i krijimit: paga mujore.**

**2.2.1.** Në rubrikën e detyrimeve, subjekti ka deklaruar: nga data 8.3.2015 – 14.11.2016 kam pasur me qira në të njëjtin pallat, k. \*\*\*, me personin që bashkëjetoj që nga marsi i vitit 2015 deri më 14.11.2016, në shumën 15,000 lekë përgjysmë me bashkëjetuesen.

**2.2.2.** Subjekti ka depozituar: kontratën e qirasë, datë 26.10.2016, e cila është vazhdim i kontratës së datës 8.3.2015, lidhur me qiradhënës D.H., dhe qiramarrës Florjan Kalaja për ap .2+1, k. \*\*\*, sip. 80.5 m<sup>2</sup> me adresë lagjja “\*\*\*\*”, Rr. “\*\*\*\*” me qira në vlerën 15,000 lekë/muaj.

**2.3. Apartament nga data 15.11.2016 dhe aktualisht, në adresën: Rruga e \*\*\*, pallati “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, k. \*\*\* + një vend parkimi. Qiraja mujore 30,000 lekë/muaj + 2,000 lekë/muaj parkimi.**

**2.3.1.** Subjekti ka depozituar: kontratën e qirasë, datë 15.11.2016, me një afat 3-vjeçar me të drejtë ripërtëritje heshtazi me qiradhënës I.M.,<sup>9</sup> dhe qiramarrës Florjan Kalaja dhe I.H. Pala qiradhënëse pranon të japë me qira vendin e parkimit me nr. \*\*\*. Çmimi i qirasë mujore do të jetë 30,000 lekë/muaj, ndërsa i parkimit do jetë 2000 lekë /muaj.

<sup>8</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 7.7.2020, me deklarues z. B.B.

<sup>9</sup> Subjekti ka depozituar dhe kontratën e sipërmarrjes, datë 11.11.2013, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., ndërmjet I.M., si porositore dhe shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k si sipërmarrës për ndërtimin e e apartamentit me sip.115.5 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, k. \*\*\*, shk. \*\*\*; ap. me sip.96.8 m<sup>2</sup>; ap. me sip. 73 m<sup>2</sup> dhe ap. me sip. 73 m<sup>2</sup> me çmimin 282,810 e në total likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.



**2.3.2.** Komisioni ka hetuar dhe për ndonjë situatë të mundshme konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me shtetasit I. Ç., S., dhe D.K., I.M., D.H., dhe B.B., dhe nga korrespondenca e kryer me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>10</sup>, nuk rezultoi ndonjë situatë e tillë.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar periodikisht marrëdhënien dhe shpenzimet e qirasë dhe nuk konstatoi ndonjë problematikë.**

**3. Shtëpi e prindërve, lagjja “\*\*\*”, Fushë-Krujë, në përdorim. Subjekti deklaroi “referohuni shkresave”** (pasuri e trajtuar në pikën 15 të vendimit).

**4. Llogari në “Raiffeisen Bank”, “Procredit”, “Credins Bank”, “Intesa Sanpaolo Bank” dhe BKT. Subjekti deklaroi “referojuni akteve”. Pjesa: 100%.**

**4.1 “Raiffeisen Bank”<sup>11</sup>** konfirmon që subjekti i rivlerësimit ka qenë klient i bankës, por llogaritë e tij bankare janë mbyllur. Referuar pasqyrave të llogarive bankare subjekti ka pasur një llogari rrjedhëse në lekë në të cilën ka pasur veprime në vitet 2007 – 2008 para periudhës së emërimit si gjyqtar. Subjekti ka pasur edhe një llogari page në të cilën për vitet 2008 – 2010 ka përfituar bursën nga Shkolla e Magjistraturës. Të dy llogaritë bankare janë mbyllur në datën 15.7.2016.

**4.2 “ProCredit Bank”<sup>12</sup>** konfirmon se subjekti ka pasur një llogari kursimi për periudhën para emërimit si gjyqtar. Në këtë llogari nuk janë kryer transaksione deri në momentin e mbylljes së saj në datën 31.7.2008. Gjithashtu, subjekti ka pasur edhe një llogari rrjedhëse ku janë kryer transaksione vetëm në vitet 2007 dhe 2008. Llogaria është mbyllur në datën 10.4.2011.

**4.3. “Credins Bank”<sup>13</sup>** konfirmon që subjekti ka pasur një llogari page në të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka kaluar pagat për periudhën 1.11.2010 – 4.1.2012. Kjo llogari është mbyllur në datën 31.3.2015.

**4.4. “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>14</sup>** konfirmon se subjekti ka pasur llogari pranë kësaj banke ku në vitin 2008 kanë kaluar pagat nga Ministria e Drejtësisë dhe llogaria është mbyllur në datën 3.11.2009.

**4.5. BKT-ja<sup>15</sup>** konfirmon llogari rrjedhëse në lekë në emër të subjektit të hapur në datën 20.11.2013, ku kryesisht kanë kaluar pagat nga universiteti ‘Pavarësia’, Vlorë. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 është 0 (zero) lekë.

Subjekti në datën 25.4.2017 ka hapur një llogari rrjedhëse në monedhën euro në të cilën kanë kaluar pagesat e përfituara prej tij si trajnues dhe ekspert në projekte të ndryshme.

**4.6. Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar llogaritë bankare të referuara vetëm si llogari në bankat respektive nga subjekti, por subjekti nuk ka deklaruar numrin e llogarisë dhe gjendjet e tyre deri në datën kur ka bërë dorëzimin e dokumentacionit në ILDKPKI.**

**4.6.1.** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe në shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore ka shpjeguar se në lidhje me llogaritë bankare në “ProCredit Bank”, BKT, “Credins Bank”,

---

<sup>10</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2020.

<sup>11</sup> “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\* prot, datë 24.8.2020.

<sup>12</sup> “Procredit Bank” me nr. prot. \*\*\* , datë 11.8.2020.

<sup>13</sup> “Credins Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020.

<sup>14</sup> “Intesa Sanpaolo Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 19.8.2020.

<sup>15</sup> BKT me nr. \*\*\* prot., datë 20.08.2020.

“Raiffeisen Bank” dhe “Intesa Sanpaolo Bank” në monedhën lekë kanë qenë me gjendje 0 (zero) në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

**4.7.2** Subjekti ka bashkëlidhur dokumentet bankare të marra rishtazi nga bankat ku konfirmohen gjendjet e tyre<sup>16</sup>.

**Komisioni vlerëson se pavarësisht konstatimit se subjekti nuk ka deklaruar llogaritë bankare me të dhënat përkatëse (nr. llogarie dhe gjendja më 31 dhjetor), ka depozituar dokumentacion të plotë në lidhje me këto llogari, ku pasqyrohet gjendja e secilës prej tyre në momentin e deklarimit, duke e konsideruar këtë pasaktësi në deklarim me një peshë të papërfillshme në vlerësimin tërësor të subjektit në lidhje me kriterin e pasurisë**

**5. Të ardhura nga shitja e librave “Gjykimi në mungesë në procesin civil” dhe “Dilema Kushtetuese I”, afërsisht në shumën 600,000 lekë (shitjet janë kryer ose gjatë promovimeve ose nga shtëpia botuese ose nga librari të ndryshme në Tiranë dhe Vlorë nga viti 2014 – 2016 ku 30% - 40% e shumës mbahet nga shitësi+tatimet)**

**5.1.** Në DIPP-në e vitit 2014 subjekti deklaroi: *“Të ardhura nga shitja e librit ‘Gjykimi në mungesë në procesin civil’. Nga qershori deri tani janë shitur 172 kopje x 2000 lekë çmimi = 254,000 lekë.”*

Në lidhje me shpenzimet e botimit, subjekti ka deklaruar: *“Shpenzime për botimin e librit ‘Gjykimi në mungesë në procesin civil’. Shiko faturat e shlyerjes së detyrimeve. Nuk ka deklaruar vlerë.”*

**5.2.** Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti deklaroi: *“Të ardhura nga libri ‘Gjykimi në mungesë në procesin civil’ çmimi për libër është 2,000 lekë. Gjithsej janë botuar 500 libra, 300 prej tyre në vitin 2014 (qershor) dhe 200 prej tyre në vitin 2015. Shuma, përafërsisht rreth 200,000 lekë (pagesat janë shlyer periodikisht...). Në lidhje me shpenzimet e botimit subjekti në DIPP-në e vitit 2015 nuk deklaroi shpenzime për botim.*

**5.3.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vitin 2015, në cilësinë e personit të lidhur me I.H., të ardhura nga libri “Gjykimi në mungesë në procesin civil”, në shumën 100,000 lekë.

Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: *“Të ardhura nga libri ‘Gjykimi në mungesë në procesin civil’, çmimi për libër 2,000 lekë. Shuma, afërsisht 60,000 lekë. Të ardhura nga libri ‘Dilema Kushtetuese I’, çmimi për libër 2,000 lekë. Shuma, afërsisht 140,000 lekë”.*

**5.4.** Subjekti nuk ka depozituar kontratë të lidhur më shtëpinë botuese “F.N.” për botimin e librave “Gjykimi në mungesë në procesin civil” dhe “Dilema kushtetuese I”, ku të jenë të përcaktuara kostot e botimit, si dhe pjesën e të ardhurave pas pagesës së tatimit që përfiton autori.

**5.5.** Me vërtetimin e datës 24.10.2016 të shtëpisë botuese “F.N.”, konfirmohet botimi i librit “Gjykimi në mungesë në procesin civil” me një tirazh total prej 500 njësi, ku për botimin e parë prej 300 njësisish subjekti ka paguar 150,000 lekë, ndërsa për botimin e dytë prej 200 njësisish ka paguar 76,000 lekë. Gjithashtu, shtëpia botuese konfirmon botimin e 300 kopjeve të librit “Dilema Kushtetuese I”, për botimin e të cilave subjekti ka paguar 217,000 lekë.

**5.6.** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar si dokumentacion provues për përfitimin e të ardhurave nga shitja e botimeve:

a) *fletëhyrje, datë 26.6.2014, për librin “Gjykimi në mungesë në procesin civil”, sasia 30 copë me çmimin 2,000 lekë me shitës Florjan Kalaja dhe blerës “A. LTD”;*

---

<sup>16</sup> Shihni dokumentacionin bankar të depozituar nga subjekti bashkëngjitur prapësimeve të tij.

- b) fletëdalje, datë 24.2.2016, për librin “Dilema Kushtetuese I”, sasia 10 copë me çmimin 2,000 lekë me shitës Florjan Kalaja dhe blerës L.Z. ;
- c) faturë shitje (jo tatimore,) datë 25.2.2016, me palë shitëse Florjan Kalaja dhe palë blerëse “A. LTD” të librit “Gjykimi në mungesë në procesin civil” në sasinë 8 copë në vlerën 10,400 lekë;
- d) faturat tatimore të shitjes me shitës R.H., si përfaqësues i shtëpisë botuese “F.N.”: (i) faturë tatimore shitje nr. \*\*\*, datë 26.2.2016, në vlerën 21,000 lekë, sasia 15 copë; (ii) nr. 15, datë 26.2.2016, në vlerën 42,000 lekë, sasia 30 copë; (iii) nr. \*\*\*, datë 26.2.2016, në vlerën 32,000 lekë, sasia 20 copë; (iv) nr. \*\*\*, datë 7.3.2016, në vlerën 9,800 lekë, sasia 7 copë.

**5.7.** Në fletëhyrjen e datës 26.6.2014 dhe fletëdaljen e datës 24.2.2016 është shënuar çmimi i shitjes për lexuesin përfundimtar, por nuk përcaktohet çmimi i shitjes për librarinë/shpërndarësin. Për subjektin e rivlerësimit çmimi me të cilin botimet i janë shitur librarisë përfaqësojnë një të ardhur, por duke qenë se ky çmim nuk është evidentuar në dokument nuk mund të përcaktojmë masën e të ardhurave të përfituara prej tij.

**5.8.** Me faturën e shitjes jo tatimore, datë 25.2.2016, provohet se subjekti ka përfituar në mënyrë të drejtpërdrejtë të ardhura në shumën 10,400 lekë, por nuk provohet pagesa e tatimit për fitimin e realizuar si diferencë midis të ardhurave nga shitja e librave me koston e paguar për botimin e tyre.

Me faturat tatimore të shitjes nga shtëpia botuese “F.N.” provohen të ardhurat e përfituara nga shtëpia botuese në shumën totale prej 104,800 lekësh për vitin 2016, por mungon marrëveshja e lidhur midis shtëpisë botuese dhe autorit të librit për pjesën e të ardhurave që i takojnë atij, si dhe nuk provohet pagesa e tatimit për të ardhurat e realizuara.

**5.9.** Subjekti i është kërkuar të provojë me dokumentacionin ligjor përfitimin e të ardhurave nga shitja e librave për secilin vit kalendarik si dhe pagesën e tatimit për të ardhurat e përfituara.

Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se: “... janë botuar gjithsej 500 kopje të librit ‘Gjykimi në mungesë në procesin civil’ dhe 300 kopje të librit ‘Dilema Kushtetuese I’. Shumica e tyre janë dhuruar dhe përafërsisht shumat e përfituara nga shitja e tyre në periudhën 2015 – 2017 janë gjithsej 600,000 lekë, sikurse është deklaruar.

Librat përgjithësisht janë dhuruar, por edhe janë shitur. Shitjet janë bërë në disa librari të Tiranës, në të cilat është shpërndarë nga botuesi dhe shitësi ka paguar në burim tatimin mbi të ardhurat dhe ka mbajtur 30 apo 35 % të çmimit për çdo shitje. Pjesa tjetër më është kredituar ose nëpërmjet bankës ose dorazi. Çmimi i një libri është 2.000 lekë.

Duke dashur që të shlyejë detyrimin tatimor mbi të ardhurat personale nga shitjet e dy librave të parë, në rubrikën e deklaratës tatimore për të ardhurat e tjera nga pasuria intelektuale, i kam deklaruar këto të ardhura të krijuara për periudhën kohore 2015 – 2017. Gjithashtu, në këtë zë të të ardhurave bruto kam shtuar edhe pagesën e realizuar në vitin 2017 nga Euralius për kontributin në shkrimin e Komentarit Elektronik të Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke e konvertuar në monedhën lekë sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë (shuma 2,250 euro, të ardhurave prej 600,000 lekë, për efekt të përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale të krijuar nga dy librat e parë, sipas parashikimeve të nenit 4, 8, 9 e vijues të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ i ndryshuar, i kam zbritur koston e paguara nga unë për botimin e librave, konkretisht shumën totale prej 226.000 lekësh të koston së botimit të librit ‘Gjykimi në mungesë në procesin civil’ dhe diferencën e koston totale të botimit të librit ‘Dilema Kushtetuese I’ me vlerën e mbështetjes financiare të Universitetit “Pavarësia” Vlorë, duke dalë në përfundimin se kostoja e përballuar nga unë është në vlerën 131,750 lekë. Më tej, diferenca ndërmjet shumës së përafërt të shitjeve të dy librave të parë me shumatoren e shpenzimeve të

përballuara prej meje ka nxjerrë edhe vlerën e të ardhurave personale për të cilat duhet të paguhej tatimi në masën 15 %. Për rrjedhojë, shuma prej 242,250 lekësh është vlera e të ardhurave personale të tatueshme e krijuar nga shitja e dy librave të parë gjatë periudhës 2015 – 2017 dhe se tatimi mbi të ardhurat personale i paguar për këtë shumë është 36.337,5 lekë.

Pas plotësimit të deklaratës tatimore të vitit 2017, datë 8.10.2020, sistemi elektronik i tatimeve ka nxjerrë urdhër pagesën me detyrimin principal që duhet të paguhej si tatim, konkretisht vlerën 81.208l. Kjo shumë është paguar në të njëjtën ditë, fakt që provohet nga shkresa bankare me lëndë ‘Transfertë në llogari’, e datës 8.10.2020, ora 13:52, e lëshuar nga ‘Tirana Bank’.

Së fundmi, në datën 12.10.2020, kam shlyer edhe pjesën e mbetur të detyrimit, konkretisht gjobën, kamatat nga gjoba dhe nga detyrimi principal tatimor, në vlerën totale prej 34.792 lekësh”.

Subjekti ka depozituar si dokumentacion provues për pagesën e tatimit dhe penaliteteve formularët e urdhër pagesave nga sistemi elektronik i tatimeve dhe dokumentet bankare të pagesave.

**5.10. Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka paguar detyrimin tatimor prej 36,337.5 lekësh pas depozitimit të deklaratës *Vetting* në datën 8.10.2020, për të ardhurat nga shitja e librave të krijuara, ndër vite, dhe të deklaruara në shumën 600,000 lekë.**

Subjekti i rivlerësimit shpjegon se mosnjohja e të ardhurave nga shitja e librave nuk përkon me realitetin dhe, pavarësisht se nuk ka një kontratë me shkrim me shtëpinë botuese, del e provuar nga vërtetimi i shtëpisë botuese se subjekti ka blerë shërbimin e botimit dhe ka ruajtur të drejtën e shpërndarjes, duke i shitur ato në dy eventet kryesore të promovimit, në libraritë e Tiranës ose duke i dhuruar të miqtë.

Subjekti shpjegon se të ardhurat janë deklaruar si në deklaratat periodike ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, ato janë të shtrira në kohë dhe deklaruar me përafërsi. Në momentin e realizimit të transaksioneve nuk është paguar tatimi mbi të ardhurat personale, por një detyrim i tillë fiskal, sipas legjislacionit në fuqi, është shlyer më vonë dhe se për vonesën në shlyerje janë paguar edhe kamatat ligjore dhe penalitetet respektive sikurse janë përllogaritur nga organet kompetente.

**Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat nga shitja e librave në shumën e deklaruara në deklaratat periodike. Subjekti ka paguar tatimin për të ardhurat e realizuara, me vonesë, jo në momentin e krijimit të tyre, por pas depozitimit të deklaratës *Vetting* dhe pas fillimit të procesit të rivlerësimit duke krijuar bindjen se janë paguar vetëm për këtë shkak dhe, për këto arsye nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.**

**6. Kartë krediti në “Tirana Bank” me detyrim të pashlyer në shumën 87,156.89 lekë**

**6.1.** Subjekti ka depozituar: “Kontratë kredie për lëshim karte krediti, datë 16.10.2012, lidhur me ‘Tirana Bank’ dhe Florjan Kalaja me limit 100,000 lekë”.

**6.2.** “Tirana Bank”<sup>17</sup> konfirmon kartë krediti aktive të çelur në vitin 2012 me limit 100,000 lekë me gjendje detyrimi të pashlyer në datën 23.1.2017, prej 87,156.89 lekësh.

**Nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarimin e kësaj llogarie.**

**7. Overdraft dhe llogaria rrjedhëse në “Tirana Bank”, në shumën 100,048.2 lekë**

---

<sup>17</sup> “Tirana Bank me nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2020.

**7.1.** Në DIPP-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar se: *“Detyrim që rrjedh nga kontrata e overdraftit me ‘Tirana Bank’, me gjendje aktive 200,000 lekë”*.

**7.2.** Subjekti ka depozituar kontratat për dhënie kredie bankare (overdraft) të lidhura nga viti 2013 – 2016, me “Tirana Bank” dhe shtetasin Florjan Kalaja me limit 200,000 lekë<sup>18</sup>.

**7.3.** Referuar pasqyrave të llogarisë bankare rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 14.10.2013 ka tërhequr nga llogaria e tij rrjedhëse në “Tirana Bank”, shumën 200,700 lekë me përshkrimin *“tërheqja e overdraftit”*. Overdafti, duke filluar nga data 14.10.2013, kur është marrë për herë të parë, është rinovuar çdo vit duke rezultuar në datën 31.12.2016 me gjendje në llogarinë rrjedhëse në shumën -134,925.99 lekë.

**7.4.** Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me depozitimet *cash* të kryera në llogarinë bankare në “Tirana Bank”, përkatësisht depozitimi i shumës 140,000 lekë në datën 26.9.2014 dhe depozitimi i shumës 207,500 lekë në datën 25.3.2016.

Në përgjigje të tij për depozitim e shumës 140,000 lekë, subjekti ka shpjeguar se: *“Rezulton se në datën 24.9.2014, Universiteti Pavarësia Vlorë ka kredituar llogarinë rrjedhëse në BKT shumën 202,500 lekë, shlyerje pagese si lektor.... Nga kjo shumë pas tërheqjes së vlerave 2,000 lekë dhe 10,000 lekë në datat 24.9.2014 dhe 25.9.2014, rezulton të kem tërhequr vlerën 190,500 lekë në datën 26.9.2014. Po në të njëjtën datë kam depozituar shumën 140.000 lekë në ‘Tirana Bank’, ndërsa në lidhje me depozitim e shumës 207,5000 lekë, subjekti shpjegon: “Në datën 24.3.2016, sipas llogarisë në BKT, më është kredituar shuma 199.500 lekë dhe se në datë 25.3.2016 kam tërhequr të gjithë shumën. Në të njëjtën ditë rezulton të jetë bërë edhe depozitimi i shumës prej 207.500 lekësh pranë ‘Tirana Bank’ dhe, më tej, edhe transferta bankare për llogari të z. R.H. Sikurse kam sqaruar edhe më parë, shitja e librit ka nxjerrë të ardhura gjithashtu”*.

**Komisioni vëren se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.**

**Konfirmohen veprimet bankare të tërheqjeve dhe depozitimeve nga subjekti i rivlerësimit në llogaritë e tij bankare.**

❖ **Personi i lidhur me subjektin, bashkëjetuesja I.H.,**

**8. Llogari bankare (studenti) në BKT (inaktive që prej vitit 2011)** me gjendje deri më 23.1.2017, 0 (zero) lekë. Pjesa takuese: 100%. Llogari bankare në “Raiffeisen Bank” me gjendje deri më 30.12.2016 në shumën 59,979.89 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga.

**8.1** BKT-ja<sup>19</sup> konfirmon llogarinë bankare në emër të personit të lidhur me subjektin me gjendje 0 (zero) lekë. “Raiffesien Bank”<sup>20</sup> konfirmon gjendjen e llogarisë bankare në emër të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Në këtë llogari bankare për vitet 2013 dhe 2014 është kredituar bursa nga Shkolla e Magjistraturës dhe më pas në vazhdimësi janë kredituar pagat e personit të lidhur.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarimin e kësaj llogarie.**

<sup>18</sup> Kontratë dhënie kredie bankare (overdraft) datë 14.10.2013, 13.10.2014, 5.10.2015 dhe 17.10.2016 lidhur me “Tirana Bank” dhe shtetasin Florjan Kalaja me limit 200,000 lekë.

<sup>19</sup> BKT me nr. \*\*\* prot., datë 20.8.2020.

<sup>20</sup> “Raiffeisen Bank” me nr. \*\*\* prot, datë 24.8.2020.

**9. Derdhje në llogarinë bankare në “Raiffesien Bank”** në datën 17.11.2014, në shumën 96,000 lekë. **Burimi i krijimit:** dhuratë nga prindërit.

**9.1.** Konfirmohet nga veprimet bankare depozitimi *cash* i shumës 96,000 lekë në datën 17.11.2014 nga znj. I.H.

**9.2.** Komisioni, me rezultatet e hetimit, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të depozitohë dokumentacion ligjor për të provuar burim e ligjshëm të të ardhurave për shumën 96,000 lekë, deklaruar nga bashkëjetuesja I.H., me burim *“dhuratë nga prindërit”*.

**9.3.** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se e fejuara e tij, znj. I.H., me rastin e përfundimit të vitit të dytë të Shkollës së Magjistraturës, prindërit i kanë dhuruar 700 euro (ose 96,000 lekë), të cilat i ka depozituar në llogarinë e saj në “Raiffeisen Bank”. Këto të ardhura prindërit e të fejuarës rezultojnë t’i ketë pasur si pjesë e kursimeve, ndër vite, nga të ardhurat e përbashkëta familjare të cilat rezultojnë të kenë pasur si burim: (i) pjesërisht të ardhurat e kursyera, ndër vite, për familjen nga z. L.H., (babai) nga pensioni i pleqërisë<sup>21</sup>; (ii) pjesërisht të ardhurat e kursyera nga znj. S.H., (nëna) nga puna e saj për përkujdesje dhe rritje fëmije (bashkëngjitur deklarata noteriale e punëdhënësit)<sup>22</sup>; (iii) pjesërisht të ardhura të znj. I.H., nga bursa e përfituar si kandidatë për magjistrat nga nëntor 2012 – shtator 2014 (bashkëngjitur vërtetimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Shkolla e Magjistraturës)<sup>23</sup>; (iv) pjesërisht të ardhura nga paga e motrës, znj. Xh.H., (bashkëngjitur librezë e sigurimeve shoqërore, librezë e punës dhe nxjerrja e llogarisë)<sup>24</sup>; (v) pjesërisht të ardhura nga pensioni i gjyshes, znj. M.H., rreth 15,000 lekë/muaj e cila ka ndërruar jetë më 12.5.2015 (bashkëngjitur vërtetimi i përfitimit të pensionit të pleqërisë për periudhën mars 1984 – mars 2015)<sup>25</sup>.

#### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

**9.4.** Komisioni vëren se subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka depozituar prova të mjaftueshme në lidhje me deklarinimin e personit tjetër të lidhur me subjektin, bashkëjetuesja I.H.

**Komisioni arrin në përfundimin se personi i lidhur me subjektin ka provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 96,000 lekë dhuruar nga prindërit.**

**10. Kontratë kredi bankare lidhur në datën 25.9.2015** me “Raiffesien Bank”, në shumën 206,000 lekë për një periudhë 36 muaj deri më 25.9.2018. Detyrimi i mbetur për të shlyer në shumën 129,574.26 lekë.

**10.1.** Në DIPP-në e vitit 2015, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. I.H., deklaroi: *“Kontratë kredie bankare, lidhur në datën 25.9.2015 me ‘Raiffeisen Bank’ për shumën 206,000 lekë për një periudhë 36 muaj... Shuma...në datën 25.9.2015 nga kredia e marrë, një pjesë është përdorur për të shlyer tërësisht vlerën prej 87,000 lekësh, si detyrim që buronte nga kontrata e*

<sup>21</sup> Vërtetim, datë 2.12.2020, “për vjetërsi në punë për efekt pensioni”, lëshuar nga DRSSH Korçë për z. L.H.

<sup>22</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 5.12.2020, lëshuar nga punëdhënësjja A.D., ku deklaroi se për periudhën tetor 2010 deri fund viti 2014 e ka paguar znj. S.H., me pagë 18,000 lekë/muaj.

<sup>23</sup> Vërtetim page për periudhën 1.11.2014 – 23.6.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim datë 20.10.2016 lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës.

<sup>24</sup> Nxjerrje llogarie page nga “Union Bank” si e punësuar pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.

<sup>25</sup> Vërtetim, datë 3.12.2020m lëshuar nga DRSSH Korçë për të ardhurat e përfituara nga znj. M.H., nga pensioni i pleqërisë për periudhën 16.3.1984 –13.5.2015.

*overdraftit e lidhur me 'Raiffeisen Bank' në datën 22.12.2014. Gjendja e detyrimit në vlerën prej 192,317.99 lekësh”.*

**10.2.** Subjekti ka depozituar kontratën e kredisë bankare, datë 25.9.2015, lidhur me “Raiffeisen Bank” dhe znj. I.H., për dhënien e kredisë në shumën 206,000 lekë.

**10.3.** “Raiffeisen Bank” konfirmon kredinë e marrë nga personi i lidhur, znj. I.H., në shumën 206,000 lekë, disbursuar në datën 25.9.2015, në llogarinë e pagës.

Detyrimi për kredinë (principali) në datën 31.12.2016 është në shumën 135,407.95 lekë.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarin e kësaj llogarie.**

**11. Kontratë kartë krediti (në lekë), datë 23.10.2015, në “Raiffeisen Bank” deri në limitin prej 160,000 lekësh. Detyrimi deri në datën 16.1.2017 është në shumën 153,765.08 lekë.**

**11.1.** Subjekti ka depozituar marrëveshjen mbi përdorimin e kartës së kreditit *Mastercard* e datës 23.10.2015 lidhur me “Raiffeisen Bank” dhe znj. I.H., me limit 160,000 lekë.

**11.2.** Në DIPP-në e vitit 2015, personi i lidhur me subjektin, bashkëjetuesja I.H., ka deklaruar: *“Karta e kreditit pranë ;Raiffeisen Bank’ në lekë dhe në euro”*.

**11.4.** “Raiffeisen Bank” konfirmon llogarinë për tërheqje me *Mastercard* në lekë me gjendje në datën 31.12.2016, në shumën -153,765.08 lekë.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarin e kësaj llogarie.**

**12. Kontratë kartë krediti (në euro), datë 23.10.2015, në “Raiffeisen Bank”, me limit 500 euro. Detyrimi i pa shlyer deri në datën 16.1.2017 është në shumën 17,381.4 lekë.**

**12.1** Në DIPP-në e vitit 2015, personi i lidhur me subjektin, bashkëjetuesja I.H., ka deklaruar: *“Karta e kreditit pranë ‘Raiffeisen Bank’ në lekë dhe në euro”*.

**12.2.** Subjekti ka depozituar marrëveshjen mbi përdorimin e kartës së kreditit *Mastercard*, datë 23.10.2015, lidhur me “Raiffeisen Bank” dhe znj. I.H. me limit 500 euro.

**12.3.** “Raiffeisen Bank” konfirmon llogarinë për tërheqje me *Mastercard* në euro me gjendje në datën 31.12.2016 në shumën – 381.4 euro.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me deklarin e kësaj llogarie.**

❖ **Babai i subjektit të rivlerësimit, z. Y.K.,**

**13. Pasuria tokë arë, nr. \*\*\*, në \*\*\*, Bashkia Durrës, me kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 19.9.2002, me vlerë 50,000 lekë. Pjesa takuese: 25%.**

**Burimi i krijimit:** nuk është deklaruar burimi i krijimit.

**13.1.** Subjekti ka depozituar: (i) *certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë e llojit “arë” me sipërfaqe 5090 m<sup>2</sup> me adresë në \*\*\*, Durrës, në bashkëpronësi me shtetasit D., G., Y.K., dhe Dh.Ll., me ¼ pjesë takuese; (ii) kontratë shitblerjeje e datës 19.9.2002<sup>26</sup>.*

**13.2.** ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës<sup>27</sup> konfirmon regjistrimin e pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol . \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit “arë”, me sipërfaqe totale 5090 m<sup>2</sup> në bashkëpronësi të shtetasve D., G.Y.,

<sup>26</sup> Kontratë e datës 19.9.2002, nr. \*\*\*.

<sup>27</sup> ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës me nr. \*\*\* prot, datë 23.9.2020.

dhe Dh.K., përfituar me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 19.9.2002, nga shitësit V., P., B., E., dhe E.K.

**13.3.** Subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime nëse mbi këtë tokë janë kryer investime nga bashkëpronarët *me çmimin 50,000 lekë.*

Në përgjigje të tij, subjekti ka shpjeguar se *nuk është kryer asnjë investim nga asnjë prej bashkëpronarëve dhe se prona ka rreth 6 apo 7 vite që është nxjerrë në shitje.*

**13.4.** Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe foto të gjendjes aktuale të pasurisë në fjalë ku rezulton se në këtë pasuri nuk janë bërë investime.

**Komisioni nuk konstatoi problematika në lidhje me këtë pasuri.**

**Dokumentacioni i përcjellë nga subjekti përputhet me dokumentacionin e përcjellë nga ASHK-ja Durrës.**

**14. Automjet “Mercedes-Benz”, tipi 124 (200 D), viti i prodhimit 1987, me kontratë shitblerje nr. \*\*\*, datë 12.1.2009, në vlerën 500,000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kontrata e kredisë me “Raiffeisen Bank”.**

**14.1.** Subjekti ka depozituar kontratë shitje mjeti, datë 12.1.2009,<sup>28</sup> me shitës A.K., dhe blerës Y.K., për mjetin “Mercedes-Benz” me targa \*\*\*, viti i prodhimit 1987, me çmimin 500,000 lekë.

**14.2.** DPSHTRr-ja<sup>29</sup> ka konfirmuar regjistrimin e këtij mjeti me targa \*\*\*, ndryshuar në \*\*\*, në emër të z. Y.K., i përfituar nga kontrata e shitblerjes e datës 12.1.2009 nga shitësi A.K.,<sup>30</sup>

**14.3. Analizë burimit të krijimit të kësaj pasurie, kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”**

**14.3.1.** “Raiffeisen Bank” konfirmon se z. Y.K., ka marrë një kredi në shumën 500,000 lekë<sup>31</sup> në datën 21.11.2007 dhe mbyllur më 22.9.2008, me marrjen e një kredie tjetër në shumën 604,058.32 lekë<sup>32</sup>, të cilën e ka mbyllur më 8.9.2015.

**14.3.2.** Nga pasqyrat e llogarisë bankare rezulton se kredia e parë është disbursuar në datën 21.11.2007 dhe shuma prej 435,000 lekësh është tërhequr në të njëjtën datë nga mbajtësi i llogarisë. Kjo kredi është mbyllur në datën 22.9.2008 me pagesën e shumës 450,620.95 lekë, shumë e cila ka si burim kredinë e marrë në datën 22.9.2008 në shumën 604,058.32 lekë me qëllimin mbylljen e kredisë së mëparshme. Pjesa e mbetur e kredisë është tërhequr gradualisht nga subjekti. Në datën 19.1.2009 gjendja në llogari është në shumën -24,533.89 lekë.

**14.3.3.** Komisioni gjatë hetimit administrativ ka konstatuar se babai i subjektit, ka mungesë burimi për blerjen e mjetit në datën 12.1.2009, pasi kredia e marrë në “Raiffeisen Bank” është përdorur për mbylljen e kredisë së mëparshme.

**14.3.4.** Lidhur me konstatimin e Komisionit se babai, z. Y.K., ka mungesë burimi për blerjen e automjetit “Mercedes-Benz 200 “, të vitit 1987, në shumën 500.000 lekë, subjekti sqaron se: “Ky

<sup>28</sup> Kontratë shitje nr. \*\*\*, datë 12.1.2009.

<sup>29</sup> DPSHTRR me nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2020.

<sup>30</sup> A.K., këtë mjet e ka blerë në datën 8.1.2004 me kontratën nr. \*\*\*, nga shitësi R.Ç., me çmimin 150,000 lekë.

<sup>31</sup> Kontratë kredie e datës 20.11.2007 lidhur midis z. Y.K., dhe “Raiffeisen Bank” për shumën 500,000 lekë me qëllim përdorimi “për arsye personale”.

<sup>32</sup> Kontratë kredie, datë 19.9.2008, lidhur midis z. Y.K., dhe “Raiffeisen Bank” për shumën 604,058.32 lekë dhënë pjesërisht për mbylljen e kredisë së akorduar në datën 20.11.2007 dhe pjesa e mbetur prej 153,437.37 lekësh do të mbetet si tepriçë kreditore në llogarinë e klientit.



automjet në datën 12.1.2009 është blerë me të ardhura, të cilat janë krijuar nga marrja e kredisë bankare në 'Raiffeisen Bank'. Konstatimet në relacion për ekzistencën e një kredie të mëparshme, në shumën 500.000 lekë dhe të disbursuar në datën 21.11.2007, dhe përtëritjen e këtij detyrimi nëpërmjet një kredie të re në shumën 604.058,32 lekë në datën 22.9.2008 janë të sakta dhe korrekte.

Sipas sqarimeve të prindërve edhe kredia e parë në nëntorin e vitit 2007 në shumën prej 500.000 lekësh është marrë për të blerë pikërisht automjetin 'Mercedez Benz 200', të vitit 1987, posedimi i të cilit i ka kaluar babait nëpërmjet kontratës së huapërdorjes, datë 4.1.2008, nr. \*\*\*, sipas të cilës babai mund ta përdorte sendin deri në datën 3.1.2009. Më tej, rezulton se palët nën të njëjtat kushte dhe për të njëjtin send kanë hartuar edhe kontratën e huapërdorjes, datë 6.1.2009, nr. \*\*\*, dhe se afati i kontratës së dytë të huapërdorjes ka qenë deri në datën 5.1.2010.

Sipas shpjegimeve që kam marrë nga ana e prindërit, qëllimi i këtyre veprimeve juridike ka qenë konkretizimi i marrëveshjes verbale të realizuar me pronarin e automjetit, mik i tyre, me të cilin babai dhe pronari janë dakordësuar që t'i jepet në formë kapari pjesa më e madhe e shumës së çmimit dhe ndërkohë automjeti të përdorej nga blerësi i ardhshëm deri në momentin kur të paguhej çmimi i plotë, me qëllim që gjatë kësaj kohe të provohej edhe cilësia e mjetit të vendosur për t'u blerë. Për rrjedhojë, edhe përtëritja e detyrimit të kontratës së parë të kredisë në bankë është bërë me këtë qëllim dhe se, kur është arritur të bëhet e gjithë shuma prej 500.000 lekë, ka marrë fund veprimi juridik i huapërdorjes dhe është lidhur kontrata e shitjes së automjetit, konkretisht në datën 12.1.2009. Ndaj konkludohet se e gjithë shuma prej 500.000 lekësh e çmimit të automjetit është krijuar nga kredia e vitit 2007 e përtërirë si detyrim me kredinë e vitit 2008, në 'Raiffeisen Bank'".

Subjekti i rivlerësimit ka depozituar në cilësinë e provës: (i) kontratën e huapërdorjes<sup>33</sup>, datë 4.1.2008, për përdorimin e automjetit "Mercedes-Benz", me targa \*\*\*, pa kundërshpërbllim brenda një periudhe 1-vjeçare deri më 3.1.2009; (ii) kontratën e huapërdorjes<sup>34</sup>, datë 6.1.2009, për përdorimin e automjetit "Mercedes-Benz", me targa \*\*\*, pa kundërshpërbllim brenda një periudhe 1-vjeçare deri më 5.1.2010.

Më pas, me kontratën e shitjes, datë 12.1.2009, shitësi A. K., ia shet këtë automjet z. Y.K., në shumën 500,000 lekë.

### **Vlerësimi i çështjes nga trupi gjykues**

**14.5.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse, si dhe ka depozituar në cilësinë e provës, dy kontrata huapërdorje të vitit 2008 dhe 2009 që përforcojnë idenë e pagesës së çmimit të blerjes së automjetit "Mercedes-Benz" në dy periudha të ndryshme dhe për këtë arsye evidentohet dhe mospërputhja nga Komisioni.

**Komision arrin në përfundimin se babai i subjektit ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë automjetin në vitin 2009 sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.**

<sup>33</sup> Kontratë huapërdorje nr. \*\*\*, datë 4.1.2008, me huadhënës A. K., dhe huamarrës z. Y.K., për dhënien në huapërdorje të mjetit "Mercedes-Benz", me targa \*\*\*.

<sup>34</sup> Kontrata e huapërdorje nr. \*\*\*, datë 6.1.2009, me huadhënës A. K., dhe huamarrës z. I.K., për dhënien në huapërdorje të mjetit "Mercedes-Benz", me targa \*\*\*.

**15. Truall me sip. 170 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 70 m<sup>2</sup>, 2+1 me adresë: lagjja “\*\*\*\*”, Fushë-Krujë, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me vlerë 15,320 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kontrata e privatizimit, datë 14.9.1993.**

**15.1** Subjekti ka depozituar: (i) *certifikatën për vërtetim pronësie, datë 26.7.2011, në emër të Y.K., dhe R.K., bashkëpronarë me ½ të pasurisë 170 m<sup>2</sup> truall dhe 70 m<sup>2</sup> godinë në adresën: Fushë-Krujë, lagjja “\*\*\*\*”, g. \*\*\*, sh. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*\*;* (ii) *formulari nr. \*\*\*, datës 14.9.1993, ku banesa 2+1 me adresë lagjja “\*\*\*\*”, është përfituar nëpërmjet procedurave të privatizimit në vlerën 15,320 lekë.*

**15.2.** ASHK-ja, Drejtoria Vendore Krujë<sup>35</sup> konfirmon regjistrimin e pasurisë me të dhënat si më sipër në emër të shtetasve Y.K., dhe R.K., të përfituar me kontratën e privatizimit të banesës, datë 10.10.1993, dhe kontratën e shitblerjes, datë 17.11.1993, lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa dhe qiramarrësit Y.K., për shumën 15,320 lekë.

**15.3.** ASHK-ja konfirmon, gjithashtu, se në bashkëpronësi të shtetasit Y.K., është edhe pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit pyll me sip. 483,000 m<sup>2</sup> në z. k. \*\*\*, \*\*\*, Krujë, ku ka si pjesë takuese 1/24 pjesë në këtë pasuri.

Kjo pasuri është përfituar me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 20.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila vendosi:

*1. Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 26.4.2013, “Për njohjen e së drejtës së pronësisë kthimin dhe kompensimin e pronës”, të AKKP-së Krujë duke i njohur të drejtën e pronësisë trashëgimtarëve ligjorë të H.P., (K.), etj., për pasuritë e paluajtshme tokë bujqësore, pemishte, ullishte, vreshtë, arë, pyll dhe kullotë me sipërfaqe të përgjithshme 1930.1 dynym;*

*2. Kthimin e pronës fizikisht që është e mundur dhe e lirë për t’u kthyer trashëgimtarëve ligjor të ish-pronarëve H.P., (K.) etj., sipas pjesëve takuese të përcaktuara në aktet e trashëgimisë me sipërfaqe të përgjithshme 1831.6 dynym, tokë arë dhe ullishte me sipërfaqja 211,770 dynym, tokë pyll me sipërfaqe 1,619,857 dynym dhe një sipërfaqe e pamenaxhuar nga ZVRPP prej 416,000m<sup>2</sup>, tokë arë dhe ullishte me sipërfaqe 1173 dynym dhe tokë pa fryt (rrugë+përrenj) me sipërfaqe 7.3 dynym.*

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.7.2019, me ndryshimin: *njohjen dhe kthimin e sipërfaqjes së lirë të ndodhur në sipërfaqen 714 dynym.. dhe kthimin familjes Kalaja (P.) të sipërfaqes 357 dynym etj.*

Pas depozitimit të dëshmive të trashëgimisë në ZVRPP nga trashëgimtarët, është bërë regjistrimi i këtyre pasurive në emër të 39 bashkëpronarëve ku z. Y.H.K., rezulton në listën e bashkëpronarëve me numër rendor 5 me pjesë takuese 1/24.

Kjo pasuri është përfituar nga personi i lidhur, z. Y.K., (babai i subjektit), pas depozitimit të deklaratës *Vetting*, datë 23.1.2017, në ILDKPKI nga subjekti i rivlerësimit

**Komisioni vëren se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e përcjellë nga subjekti dhe ASHK-ja, Drejtoria Vendore Krujë.**

**16. Kartë krediti në BKT, me limit shumën 150,000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.**

---

<sup>35</sup> ASHK-ja, Drejtoria Vendore Krujë me nr. \*\*\*\* prot., datë 16.9.2020.

**16.1.** Subjekti ka depozituar: (a) vërtetim nga BKT-ja, dega Fushë-Krujë, datë 13.10.2016, që z. Y.K., ka kartë krediti aktive në limitin total 150,000 lekë; (b) konfirmimin e BKT-së se detyrimi për kartën e kreditit në datën 6.1.2017 është në shumën 20,660 lekë.

**16.2** BKT-ja<sup>36</sup> konfirmon kartë krediti aktive me limit 150,000 lekë.

**Nuk konstatohen problematika në lidhje me deklarinimin e kësaj llogarie.**

**17. Llogari rrjedhëse në BKT. Personi i lidhur deklaron “referojuni akteve”. Pjesa takuese: 50 %**

**17.1.** BKT-ja konfirmon llogari rrjedhëse në lekë me gjendje në datën 31.12.2016, në shumën 20,689.82 lekë në emër të babait të subjektit. Në këtë llogari kryesisht janë bërë depozitime *cash* për pagesën e kartës së kreditit, si dhe depozitime *cash* që më pas janë tërhequr pjesë-pjesë nga mbajtësi i llogarisë bankare. Gjithashtu, në këtë llogari rrjedhëse kanë kaluar edhe dy depozita përkatësisht, në datën 18.7.2011 depozita me vlerë 25,000 lekë dhe në datën 29.7.2011 depozita me vlerë 151,480.93 lekë.

**17.2.** Subjektit i është kërkuar të japë shpjegime në lidhje me shumën prej 828,000 lekësh të depozituar *cash* me 5 veprime bankare në periudhën prill 2011 – maj 2013 nga babai në llogaritë e tij bankare në BKT (depozitimet *cash* në llogarinë e depozitës në shumat 150,000 lekë në datën 20.4.2011 dhe 50,000 lekë në datën 18.6.2011, si dhe depozitimet *cash* në llogarinë rrjedhëse në shumat 250,000 lekë, në datën 9.5.2012; 128,000 lekë në datën 5.4.2013 dhe 250,000 lekë në datën 2.5.2013).

Në përgjigje të tij, subjekti ka shpjeguar: “Nga komunikimi që kam pasur me babanë më është shpjeguar se këto shuma kanë qenë sponsorizime, konkretisht:

i) Shumat 150.000 lekë, datë 20.4.2011; 50.000 lekë datë 18.6.2011; 128.000 lekë datë 5.4.2013, kanë qenë sponsorizim i ish-deputetit të zonës, z. N.B., për organizimin e festivalit Fest Folk 2011 dhe mbështetjen e pjesëmarrjes në Festivalin Mbarëkombëtar të Këngës për Fëmijë në Shkodër;

ii) Shumat 250.000 lekë datë 9.5.2012 dhe 250.000 lekë datë 2.5.2013, janë sponsorizim nga z. Sh.Sh., në cilësinë e administratorit të shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.p.k., dhe ‘\*\*\*’ sh.p.k., për organizimin e festivalit ‘Fest Folk 2012’.

Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale datë 12.11.2020<sup>37</sup> me deklarues Y.K., i cili deklaron se në pozicionin e drejtuesit artistik të festivalit Fest Folk dhe të kreut të Ansamblit ‘A.’ dhe shoqatës kulturore dhe artistike ‘Q.A.’ ka kërkuar mbështetje financiare nga subjekte tregtarë të cilët janë treguar të gatshëm të ndihmojnë për zhvillimin e aktivitetit kryesor kulturor të qytetit të Fushë-Krujës”.

**17.3.** Subjekti ka depozituar, gjithashtu, vërtetimet e lëshuara nga shtetasi N.B.,<sup>38</sup> dhe shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k.<sup>39</sup>, si dhe mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 2.5.2013, të subjektit tregtar ‘\*\*\*’ sh.p.k., në shumën 300,000 lekë.

---

<sup>36</sup> BKT me nr. \*\*\* prot., datë 22.10.2020..

<sup>37</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 12.11.2020, me deklarues z. Y.K.

<sup>38</sup> Vërtetim i prillit 2011 për sponsorizim në shumën 150,000 lekë; vërtetim i datës 18.6.2011 për sponsorizim në shumën 50,000 lekë; vërtetim i datës 5.4.2013 për sponsorizim në shumën 128,000 lekë.

<sup>39</sup> Vërtetim i datës 9.5.2012 për sponsorizim në shumën 250,000 lekë.

**17.4.** Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime në lidhje me llogarinë e padeklaruar, e cila i korrespondon llogarisë me nr. \*\*\*, duke bashkëlidhur dhe një kopje të historikut të saj nxjerrë nga banka në datën 9.10.2020. Subjekti ka shpjeguar se në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting*, më 23.1.2017, se gjendja e llogarisë më 5.1.2017 ka qenë në vlerën 1.689,82 lekë dhe e tillë ka mbetur deri më 25.1.2017, datë në të cilën gjendja e llogarisë ka mbetur 689.82 lekë.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme duke provuar dhe me dokumentacion ligjor historikun e kësaj llogarie bankare.**

#### **18. Titull ekzekutiv vendim gjykate i formës së prerë i paekzekutuar (referojuni akteve)**

**18.1.** Subjekti ka depozituar: (i) vendimin nr. \*\*\*, datë 22.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku z. Y.K., ka përfituar si dëmshpërblim page për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga Bashkia Fushë-Krujë. Nga ky vendim gjyqësor Y.K., ka përfituar në total 28 paga mujore; (ii) vendimin nr. \*\*\*, datë 7.9.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit duke ndryshuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë duke vendosur që paditësi Y.K., të dëmshpërblehet me 17 paga mujore.

**Komisioni konstaton se deklarimi përputhet me dokumentacionin e depozituar nga subjekti.**

#### **19. Krijimtari muzikore dhe mësim privat kantoje dhe instrumenti. Personi i lidhur deklaron “llogari rrjedhëse në BKT-së”.**

**19.1.** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga babai prej krijimtarisë muzikore nuk ka deklaruar vlerën përkatëse dhe kohën kur janë përfituar ato.

**19.2.** Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka shpjeguar se: *“Në kuadër të shoqatës ‘Q.A.’ dhe ‘A. A.’, babai dhe nëna e tij kanë zhvilluar kurse për kanto dhe vegla muzikore dhe fëmijët janë aktivizuar rregullisht në aktivitetet kulturore dhe artistike të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit dhe shumë prej tyre janë përgatitur për të konkurruar në liceun artistik në Tiranë apo në Durrës. Mësimi është bërë në ambientet e shtëpisë të shtunën dhe të dielën. Të dy prindërit punojnë së bashku dhe mësimi zhvillohet në periudhën shtator – qershor të çdo viti.*

*Të ardhura vjetore neto të realizuara nga babai nga mësimi privat i instrumenteve muzikore shkojnë rreth 200.000 lekë apo 300.000 lekë.*

*Të ardhurat vjetore neto të realizuara nga nëna nga mësimi privat i kantos shkojnë rreth 240,000 deri në 300,000 lekë. Pagesat janë bërë cash nga prindërit e fëmijëve.*

*Duke pasur parasysh parashikimet e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ (i ndryshuar), mbi këto shuma të realizuara nga vetëpunësimi shkalla tatimore është 0 % (shihni nenin 8, 9 pika 1 dhe kolonën e parë të shkallës së tatimit mbi të ardhurat në pasqyrën nr. 1 të këtij ligji).”*

**19.3.** Komisioni vëren se të ardhurat nga mësimdhënia referuar Udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, kategorizohen sipas germës “g”, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe si të tilla taten në burim me 15 %.

**Komisioni ka konstatuar se personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit, nëna dhe babai i tij, kanë pasur detyrim për pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale të përfituara nga mësimdhënia. Këto të ardhura nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare për**

**periudhën e jetesës së përbashkët, pasi nuk plotësojnë kushtin e të ardhurave të ligjshme sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.**

**20. Kontratë kredie bankare për blerje automjeti në “Raiffeisen Bank”, në shumën 604,058.32 lekë**

**20.1.** Subjekti ka depozituar kontratën e kredisë, datë 19.9.2008, lidhur midis shtetasit Y.K., dhe “Raiffeisen Bank”, për shumën 604,058.32 lekë. Qëllimi i dhënies së kredisë është pjesërisht për mbylljen e kredisë së akorduar në datën 20.11.2007 dhe pjesa e mbetur prej 153,437.37 lekësh do të mbetet si tepriçë kreditore në llogarinë e klientit.

**20.2.** “Raiffeisen Bank” konfirmon kredinë e marrë në shumën 604,058.32 lekë, në datën 22.9.2008. Kjo kredi ka shërbyer për mbylljen e detyrimit të mbetur në shumën 450,620.95 lekë të kredisë 500,000 lekë, të marrë në datën 20.11.2007. Shuma e mbetur prej rreth 153,000 lekësh është tërhequr *cash* brenda muajit shtator 2008.

**Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje deklarimi në lidhje me përdorimin e kësaj kredie nga babai i subjektit, pasi në deklaratën *Vetting* deklaroi se e ka përdorur për blerjen e automjetit, ndërkohë që nga dokumentacioni bankar rezulton të jetë përdorur për mbylljen e kredisë së mëparshme.**

**Kjo mospërputhje është analizuar në pikën 14 të vendimit.**

❖ **Nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. R.K.,**

**21. Kartë krediti në “Raiffeisen Bank”, në shumën 100,000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.**

**21.1.** Sipas pasqyrave të llogarive bankare rezulton se znj. R.K., disponon në “Raiffeisen Bank” një llogari tërheqje *Mastercard* në monedhën lekë me limit 100,000 lekë dhe gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 është -46,960.12 lekë.

**Deklarimi i bërë përputhet me dokumentacionin e administruar nga Komisioni.**

**22. Krijimtari muzikore dhe mësim privat kantoje dhe instrumenti në ansamblin “A.” të shoqatës “Q.A.”. Personi i lidhur deklaroi: “shikoni llogarinë rrjedhëse në Raiffeisen Bank”.**

**22.1.** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga nëna prej krijimtarisë muzikore, nuk ka deklaruar vlerën përkatëse dhe kohën kur janë përfitur ato.

Ky deklaram është analizuar në pikën 19 të vendimit.

**Analiza financiare**

**23.** Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni përgatiti analizën financiare mbështetur në të dhëna në deklaratimet periodike vjetore në ILDKPKI, deklaratës *Vetting*, informacioneve të ardhura nga institucionet përkatëse dhe deklaratimet e subjektit.

**23.1. Metodologjia e kryerjes së analizës financiare**

Për efekt të pasqyimit të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare është bazuar në: deklaratat e interesave pasurore private/vjetore; deklaratën *Vetting*; pyetësorët me përgjigjet e subjektit, si dhe në korrespondencën e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Kjo metodologji shërben për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të realizuar kursimet, pasuritë e deklaruara dhe për të paguar shpenzimet, si dhe evidentimin e rasteve kur subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të

ligjshme pasuritë e krijuara (pasuri të luajtshme, të paluajtshme, likuiditete) dhe shpenzimet e kryera.

**23.1.1.** Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar bazohet në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat nga pagat dhe honoraret në vlerë *neto*, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të<sup>40</sup>, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**23.1.2.** Për të ardhurat nga shitja e botimeve është marrë në analizë vlera 0 (zero) lekë, pasi subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor shumat e përfituara për periudhën 2014 – 2016, si dhe pagesa e detyrimit tatimor për diferencën e të ardhurave të deklaruar nga shitja në shumën 600,000 lekë me koston e paguar për botim në shumën 357,750 lekë është bërë në datën 8.10.2020.

**23.1.3.** Në rubrikën e detyrimeve janë pasqyruar kreditë bankare të marra në “Raiffeisen Bank”<sup>41</sup> dhe “Fondi Besa”<sup>42</sup>.

Lidhur me shpenzimet e deklaruar, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklaramëve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit. Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë sa më poshtë:

**23.1.4. Shpenzimet e jetesës** – u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së drejtuar Komisionit. Shpenzimet jetike për periudhën 30.9.2010 – 31.12.2011 janë llogaritur për familje me 4 anëtarë, për periudhën 2012 – 30.6.2015 janë llogaritur për familje me 1 anëtar, ndërsa për periudhën 1.7.2015 – 31.12.2016 janë llogaritur për familje me 2 anëtarë sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin standard.

**23.1.5. Shpenzime qiraje** – janë marrë në konsideratë vlerat e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike dhe shpjegimet e dhëna në pyetësor.

**23.1.6. Shpenzime udhëtimi për në vendin e punës** – janë marrë në analizë vlerat sipas deklaramëve të subjektit në pyetësorë.

---

<sup>40</sup> Vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pagat e përfituara në periudhën 1.10.2010 - 21.12.2011 nga subjekti; vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2017, për periudhën 2012 - 16.11.2016; vërtetim i Gjykatës së Lartë me nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2017, për periudhën 16.11.2016 - 31.12.2016; vërtetim i revistës “A.” datë 27.10.2016; vërtetim i Kolegjit Universitar “Vlorë” me nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2020; vërtetim i Shkollës së Magjistraturës me nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016; vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pagat e përfituara në periudhën 1.11.2014 - 23.6.2016, nga personi i lidhur me subjektin; vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec me nr. \*\*\* prot, datë 14.10.2016, për periudhën 23.6.2016 - 30.9.2016; vërtetim i revistës “A.” datë 27.10.2016; pasqyra e llogarisë së pagës në “Raiffeisen Bank” dhe librezat e punës për R.K., dhe Y.K., për pagat e përfituara në periudhën 1.10.2010 - 31.12.2011.

<sup>41</sup> Kontratë kredie bankare e datës 22.9.2008 me palë huamarrëse Y.K., dhe palë huadhënëse “Raiffeisen Bank” në shumën 604,058 lekë, me afat 84 muaj me qëllim mbylljen e kredisë së mëparshme prej 500,000 lekësh të marrë në datën 20.11.2007; kontratë kredie bankare e datës 25.9.2015, me huamarrëse I.H., dhe huadhënëse “Raiffeisen Bank” në shumën 206,000 lekë; kontratë kredie bankare e datës 30.9.2010, me huamarrëse R.K., dhe huadhënëse “Raiffeisen Bank” në shumën 190,000 lekë me afat 36 muaj; kontratë kredie bankare datë 22.7.2011, me huamarrëse R.K., dhe huadhënëse “Raiffeisen Bank” në shumën 146,800 lekë, me afat 12 muaj.

<sup>42</sup> Kontratë huaje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.5.2010, me huamarrës A.K. dhe huadhënëse Fondi Besa sh.a., me afat 12 muaj; kontratë huaje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.9.2011, me huamarrës A.K., dhe huadhënëse Fondi Besa sh.a., me afat 12 muaj me qëllim financim kapitali.

**23.1.7. Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit** – u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrëse-dalëse nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit të dhëna në pyetësorë. Për llogaritjen e shpenzimeve i jemi referuar deklaratimeve të subjektit dhe standardit të vendosur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në lidhje me çmimet e biletave dhe shpenzimeve për karburant; shpenzimeve ditore të qëndrimit.

**23.1.8. Shpenzimet e mobilimit** – janë marrë në analizë sipas deklaratimit të subjektit në pyetësorë.

**23.1.9. Shpenzime për promovimin e librave të botuar**<sup>43</sup> – janë marrë në analizë vlerat sipas dokumentacionit provues ligjor.

**23.1.10. Shpenzime botimi**<sup>44</sup> – janë marrë në analizë vlerat sipas vërtetimit të shtëpisë botuese.

**23.1.11. Shpenzime kredie** – janë marrë në analizë vlerat sipas dokumentacionit bankar, ku përfshihen pagesat për principalin, interesat, penalitetet, komisionet e disbursimit vetëm për vitet e analizuar. Kreditë, të cilat janë disbursuar para periudhës së hetimit ose edhe gjatë periudhës së hetimit për familjarët e subjektit të rivlerësimit gjatë kohës që subjekti nuk ka jetuar me ta, nuk janë llogaritur në analizën financiare.

**23.1.12. Shpenzim i kredisë konsumatore** – për kreditë e marra nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, është marrë si shpenzim pjesa e mbetur nga disbursimi i kredisë pas pagesës së *overdraft*-it prej 87,000 lekësh, ndërsa për kreditë konsumatore të marra nga nëna dhe vëllai i subjektit dhe të disbursuara në periudhën 30.9.2010 – 31.12.2011, janë marrë në analizë vlerat e tërhequra nga banka dhe të shpenzuara sipas destinacionit të përcaktuar në kontratë.

Lidhur me pasuritë e krijuara dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën *Vetting*, si dhe aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

**23.1.13. Ndryshimi në likuiditete (cash dhe bankë)** përfaqëson diferencën e gjendjes së likuiditeteve në fund të vitit me gjendjen e likuiditeteve në fillim të vitit.

**23.1.13.1.** Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore. Deklarimet e subjektit për gjendjen *cash* të akumuluar përputhen me gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*.

**23.1.13.2.** Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë<sup>45</sup>, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare të individëve.

---

<sup>43</sup> Kontratë nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2016 për dhënie me qira të sallës “\*\*\*\*” për promovim libri në vlerën 10,000 lekë; faturë për arkëtim nr. \*\*\*, datë 4.3.2016, në vlerën 10,000 lekë, me përfitues Muzeu Historik Kombëtar; faturë nr. \*\*\*, datë 24.3.2016, me vlerën 33,600 me përfitues “H.G.”.

<sup>44</sup> Vërtetim i datës 24.10.2016, i shoqërisë botuese “F.N.”.

<sup>45</sup> Si ndryshim në likuiditete për vitin 2010 janë marrë diferencat e llogarive bankare në fund të vitit me datë 31.12.2010 me gjendjen e tyre në fillim të periudhës me datë 30.9.2010 (data 30.9.2010 është data kur fillon periudha e hetimit për subjektin e rivlerësimit); nga viti 2012 subjekti deklaroi se ka jetuar vetëm. Duke nisur nga kjo datë nuk do të merren më në analizë të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e prindërve dhe vëllait të tij. Në datë 31.12.2011 gjendja totale e llogarive bankare është - 62,358 lekë. Në datë 31.12.2012 gjendja e këtyre llogarive për shkak të “largimit” nga analiza financiare do të konsiderohet 0 lekë. Ndryshimi në likuiditete në vitin 2012 për shkak të “largimit” është 62,358 lekë, pra, duket sikur kemi shtim pasurie prej 62,358 lekë. Për të neutralizuar këtë efekt në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit, në vitin 2012 shënojmë në analizë zërin “shpenzime për llogaritë bankare për efekt

**23.1.14.** Lidhur me pasurinë e luajtshme (automjet)<sup>46</sup> të krijuar është marrë në konsideratë vlera sipas kontratës së shitblerjes.

**23.1.15.** Rezultati është i përlogaritur për çdo vit kalendarik, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total dhe rezulton si shumatore: të ardhura + detyrime – shpenzime - pasuri.

**Komisioni arrin në përfundimin se nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore dhe deklaratës *Vetting* për periudhën e hetimit, pra, 30.9.2010 – 2016, të kryer nga Komisioni rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë.**

Viti	30.09.2010-31.12.2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>Të ardhurat</b>	499,415	2,011,640	807,016	889,575	1,398,431	1,958,321	2,411,406
<b>Detyrime</b>	190,000	246,800	0	0	0	206,000	0
<b>Shpenzime</b>	400,786	1,532,309	383,838	464,320	776,559	1,235,307	1,677,636
<b>Pasuri</b>	-147,917	10,979	39,789	-107,782	-139,212	647,203	66,237
<b>Rezultati</b>	436,546	715,153	383,389	533,037	761,084	281,810	667,532

## B. KONTROLLI I FIGURËS

**24.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka dërguar në Komision me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2020, raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.11.2020, të KDZH-së dhe nga Grupi i Punës është konkluduar se:

*“Për subjektin e rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”.*

**24.1.** Për sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Florjan Kalaja.

Grupi i Punës, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, nuk ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, z. Florjan Y. Kalaja, për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës.**

## C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

**25.** Grupi i Punës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të

llogaritje” në shumën -62,358 lekë; si ndryshim në likuiditete për llogaritë bankare të personit të lidhur I.H., për vitin 2015 është marrë në analizë diferenca e gjendjes në fund të vitit 31.12.2015 me gjendjen e llogarisë në datën 1.7.2015 (kur ka filluar jetesa e përbashkët sipas deklaramit të subjektit në pyetësorin standard).

<sup>46</sup> Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.3.2015.



rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar raportin nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2020, mbi aftësitë profesionale, për subjektin e rivlerësimit, z. Florjan Kalaja.

**25.1.** Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit në drejtim të:

*a) Aftësive profesionale*

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Po kështu, ka aftësi në arsyetimin ligjor dhe vendimet e dhëna prej tij plotësojnë kërkesat e legjislacionit procedural civil dhe penal.

*b) Aftësive organizative*

Subjekti ka aftësi në përballimin e ngarkesës në punë, në planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, si dhe në inventarizimin e rregullt dhe sistemimin në mënyrë kronologjike të dosjeve.

*c) Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale*

Në lidhje me etikën nuk rezulton që gjatë periudhës së rivlerësimit ndaj subjektit të jetë regjistruar kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore, nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm, si dhe nuk rezulton që subjekti të mos ketë respektuar rregullat procedurale që cenojnë parimin e gjykatës së paanshme.

*e) Aftësive personale dhe angazhimi profesional*

Rezulton se subjekti komunikon me etikë me palët dhe nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese.

## **26. Vlerësimi i tri dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

**26.1.** Grupi vlerësues pranë KLGj-së ka analizuar tri dokumentet<sup>47</sup> e paraqitura nga subjekti dhe nuk ka konstatuar problematika.

**Komisioni, pas administrimit të dokumentacionit dhe raportit të vlerësimit profesional dhe hetimit të kryer, vlerëson se nuk konstatohen problematika apo mangësi që do të çonin në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket kriterit profesional.**

## **27. Vlerësimi i pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor dhe objektiv**

**27.1.** Në tri dosjet gjyqësore dhe konkretisht: dosja 2 - çështja civile me nr. \*\*\* regj., datë 1.6.2016<sup>48</sup>; dosja 4 - çështja civile me nr. \*\*\* regj., datë 17.11.2014<sup>49</sup> dhe dosja 5 - çështja

---

<sup>47</sup> Vendimi i pezullimit për çështjen civile me nr. \*\*\* akti, datë 11.9.2013 regj., i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; vendimi i pezullimit për çështjen civile me nr. \*\*\* akti, datë 9.2.2015 regj., i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; vendimi i pezullimit për çështjen civile me nr. \*\*\* akti, datë 26.8.2016 regj., i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

<sup>48</sup> Që i përket paditëses B.F., kundër të paditurit \*\*\* sh.p.k., me objekt “detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen për zgjidhjen e menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës me pagën e 12 muajve, etj.”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2016.

<sup>49</sup> Që i përket paditësit B.N., kundër të paditurve A.N., e K.N., me persona të tretë P. Gj. e E. H., me objekt “detyrimin e të paditurve të më lirojnë e dorëzojnë sipërfaqen e tokës arë që më kanë pushtuar dhe “dëmshpërblimin për shfrytëzimin e tokës”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.5.2015.

administrativo-penale me nr. \*\*\* regj., datë 10.1.2016<sup>50</sup>, nga Grupi i Punës pranë KLGj-së nuk janë konstatuar problematika.

**Komisioni, pas administrimit të dokumentacionit dhe raportit të vlerësimit profesional dhe hetimit të kryer, vlerëson se nuk konstatohen problematika apo mangësi që do të çonin në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket kriterit profesional.**

**27.2.** Në dy dosje<sup>51</sup> janë konstatuar problematika nga Grupi i Punës, si vijon:

**27.2.1.** Në dosjen 1- çështja civile me nr. \*\*\* regj., datë 16.1.2014,<sup>52</sup> nga Grupi i Punës është konstatuar se: (a) kohëzgjatja e gjykimit është tej afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk respekton standardin e procesit të rregullt ligjor; (b) në procesverbalet e seancave gjyqësore nuk qartësohet seanca përgatitore nga ajo gjyqësore; (c) në procesverbalin e seancës së fundit është pasqyruar vetëm dispozitivi i vendimit dhe mungojnë të pasqyruara përbërja e trupit gjykues e pjesëmarrësit në gjykim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile; (ç) Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 22.4.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë, duke pranuar padinë e paditësit... me arsyetimin se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk janë respektuar dispozitat e ligjit material civil që lidhet me legjitimitetin në ngritjen e padisë dhe nga pikëpamja e ligjit procedural fitimit të titullit të pronësisë nga paditësi.

**27.2.2.** Në lidhje me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore, ka shpjeguar ndër të tjera se:

**a)** Në lidhje me kohëzgjatjen e gjykimit, shkaqet e shtyrjeve të 11 seancave kanë të bëjnë me plotësimin e të metave të padisë, dhënien e mundësisë së palës paditëse për individualizimin e adresave të të paditurve, njoftimin e të paditurve të rinj, realizimi i dy njoftimeve me shpallje publike, përsëritja e njoftimeve të paditurit dhe një seancë është shtyrë për mungesën e gjyqtarit;

**b)** Në lidhje me mospërputhjet e evidentuara për sa i përket cilësimit “seancë përgatitore” apo “seancë gjyqësore” në procesverbalet e seancave gjyqësore, subjekti ka shpjeguar se në procesverbalin në audio që ai ka bashkëngjitur prapësimeve, duket qartë që nuk përputhet ekstrakti që ka prodhuar sekretarja, por ai akt nuk mund të prevalojë ndaj CD-së, për arsye se kur procedohet me procesverbal audio, procesverbali si akt procedural nuk është ekstrakti që printon sekretari gjyqësor pas çdo seance, por është regjistrimi audio në pajisjet respektive, i cili në përfundim të gjykimit materializohet në një CD dhe bëhet pjesë e fashikullit të gjykimit, kjo duke sjellë në vëmendje edhe vendimin unifikues nr. 1, të vitit 2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që arrin në konkluzionin: “... *ekstraktet e procesverbaleve në rastet kur mbahet procesverbali audio, nuk mund të prevalojnë dot ndaj dokumentit autentik që është cd-ja; Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv, është jo vetëm në përputhje me nenin 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, por duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit, rrit*

---

<sup>50</sup> Që i përket Kërkesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndaj personit nën hetim A.K., me objekt “vleftësimin e ligjshëm të ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, parashikuar në nenin 234 të Kodit të Procedurës Penale, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.1.2016.

<sup>51</sup> Dosjen 1 dhe dosjen 3.

<sup>52</sup> Që i përket paditësit Dh.Dh., kundër të paditurve B.S., etj., me objekt “detyrimin e të paditurve të na njohin pronarë dhe të na lirojnë pasurinë shtëpi \*\*\*katëshe e ndodhur në Vlorë, në vendin e quajtur ...”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.4.2015.

*efektivitetin, eficiencën dhe garanton transparencën në seancat gjyqësore duke përmbushur në mënyrë shteruese dhe autonome funksionin dokumentues të veprimeve procedurale.”*

c) Në lidhje me procesverbalin e seancës së fundit sipas të cilit subjekti nuk ka respektuar nenin 118 të Kodit të Procedurës Civile sepse nuk ka mbajtur procesverbalet me të gjithë ekstremitetet e këtij neni, sipas procesverbaleve audio rezulton se janë respektuar kërkesat e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile.

ç) Në lidhje me ndryshimin e vendimit nga Gjykata e Apelit Vlorë me arsyetimin se nuk janë respektuar dispozitat e ligjit material civil që lidhet me legjitimitetin në ngritjen e padisë dhe nga pikëpamja e ligjit procedural fitimit të titullit të pronësisë nga paditësi, subjekti ka shpjeguar se në vendimmarrjen e tij është referuar dhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese, konkretisht në vendimet nr. 4, datë 8.4.1994 dhe nr. 30, datë 1.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese.

Subjekti qartëson se, ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 30/2005 arsyeton se: *“Mbështetur te referimi në jurisprudencën kushtetuese shqiptare, në kuptimin e nenit 181 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në kuptimin e përmbajtjes së legjislacionit të nxjerrë nga ligjvënësi, pavarësisht nga veprimet e padrejta ose arbitrare që i janë bërë të drejtës së pronës nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore ose vendimeve gjyqësore, nxirret konkluzioni se pronarëve u humbi e drejta e pronësisë. Ky konkluzion përbën arsyen që këta persona, duke mos gëzuar në vijimësi pronat e tyre në cilësinë e pronarit kërkojnë që, nëpërmjet procedurës së kthimit dhe kompensimit të pronës, të rifitojnë këtë cilësi.*

*Gjykata Kushtetuese vëren se mbajtja e një qëndrimi të kundërt, që parakupton njohjen e të drejtës së pronës, si një njohje e vazhdueshme dhe e pandërprerë e ekzistencës së saj, me gjithë ligjet që e kanë ndryshuar regjimin e kësaj pronësie, vë në dyshim si qëllimin ashtu edhe vetë vlefshmërinë e ligjeve që janë nxjerrë për çështjen e kthimit dhe të kompensimit të pronave.*

*Mbështetur në këto argumente, Gjykata Kushtetuese nxjerr përfundimin se ligji ‘Për kthimin dhe kompensimin e pronave’ nuk ka në përmbajtjen e tij konceptin e shpronësimit të pronës së pronarëve, por respektimin nga ligjvënësi të kriterëve që parashikon neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë për kthimin e pronave të shpronësuar, të konfiskuara apo të shtetëzuara padrejtësisht”.*

**27.2.4.** Komisioni, në lidhje me prapësimet e dhëna nga subjekti, pasi ka administruar dokumentacionin, si dhe CD-në e kësaj çështjeje ka konkluduar:

Çështja në fjalë është një çështje pronësie komplekse me shumë palë dhe shkak i kohëzgjatjes së gjykimit ka qenë vështirësia e njoftimit të palëve. Gjykatës i është dashur vazhdimisht të shtyjë seancat gjyqësore për shkak të mosmarrjes dijeni të palëve në proces. Kohëzgjatja e gjykimit ka qenë për arsye të përligjura dhe jo për shkak të mosmenaxhimit nga ana e subjektit.

Pas analizimit të CD-së, vënë në dispozicion nga subjekti, konstatohet se cilësimi i seancave gjyqësore në materialin audio ishte i saktë dhe në përputhje me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

Nga analizimi i CD-së që përmban procesverbalin audio të seancës së fundit të datës 22.4.2015 subjekti i rivlerësimit ka cituar dispozitivin e vendimit në përputhje me dispozitat e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile.

**Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë, ndër të tjera, shpjegime të mjaftueshme duke mos u konstatuar problematika apo mangësi të karakterit procedural, që**

**do të mund të çonin në një vlerësim negativ të subjektit të rivlerësimit për sa i përket kriterit profesional.**

**27.3.** Në dosjen 3 – çështja civile nr. \*\*\* regj., datë 4.8.2014<sup>53</sup>, nga Grupi i Punës pranë KLGj-së është konstatuar se: (i) në procesverbalet gjyqësore të datave 21.10.2014, 30.10.2014 dhe 13.11.2014, nuk është shënuar ora e zhvillimit të seancës, por vetëm data e saj; nuk janë të shënuara gjeneralitetet e palëve; mungon nënshkrimi i gjyqtarit të çështjes, kërkesa këto të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile; (ii) në dosjen gjyqësore nuk gjendet i administruar asnjë dokument që të vërtetojë të drejtën e shtetasit K. G., për të ushtruar detyrën e psikologut (diploma).

**27.3.1.** Për konstatimet e mësipërme, subjektit të rivlerësimit iu kërkuan shpjegime dhe prova në lidhje me barrën e provës të referuar në rezultatet e hetimit.

**27.3.2.** Subjekti, në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se në legjislacionin procedural, administrativ, civil dhe penal, nuk ka asnjë parashikim që të thotë, diploma e psikologut, licenca e ekspertit bëhet pjesë e fashikullit të gjykimit, qoftë edhe kopje të saj. Aq më tepër kur palët nuk kanë asnjë lloj kontestimi. Neni 155 i Kodit të Familjes nuk parashikon që të detyrojë gjykatën të administrojë si provë diplomën e ekspertit që cakton.

Në lidhje me konstatimin se nuk janë mbajtur procesverbalet me të gjithë ekstremitetet që thotë Kodi i Procedurës Civile, nga procesverbalet audio të seancave rezulton se është respektuar neni 118 i Kodit të Procedurës Civile.

**27.3.3.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimi ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për sa i përket respektimit të kriterëve të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile.

Në lidhje me ekspertin psikolog, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se dispozitat ligjore në fuqi<sup>54</sup> nuk parashikojnë detyrimin e gjykatës të administrojë si provë diplomën e ekspertit psikolog që cakton për të kryer aktin e ekspertimit, ndërkohë që nga subjekti në procesverbalet e seancave gjyqësore është pasqyruar fakti ku gjykata ka caktuar ekspertin psikolog K. G., për kryerjen e aktit të ekspertimit dhe nga palët nuk ka pasur qëndrime apo kundërshtime në lidhje me kryerjen e aktit të ekspertimit nga eksperti i caktuar nga gjykata.

**Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me konstatimet e Grupit të Punës. Gjetjet e evidentuara në raportin profesional, nuk mund të kualifikohen si shkelje që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me kriterin profesional.**

## **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË**

**28.** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Florjan Kalaja janë paraqitur ankesat si vijon:

**28.1. Ankesa e shtetas A.K.,** e vitit 2014, ku pas verifikimit nga Inspektorati pranë KLD-së, subjektit i është dërguar “*tërheqje vëmendje*” me shkrim për arsye se nga verifikimi i ankesës ka rezultuar se nga subjekti është shkelur neni 118/d dhe 125 i Kodit të Procedurave Civile, është

---

<sup>53</sup> Që i përket paditëses B.A., me të paditur Y.A., me objekt “zgjidhje martesë dhe lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim paditësit”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.11.2014, ku subjekti ka gjykuar si gjyqtar i vetëm.

<sup>54</sup> Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Familjes.

larguar nga seanca gjyqësore për t'u njohur me kërkesën e përjashtimit që i ishte bërë nga ankuesja duke u konsultuar me gjyqtaren që do gjykonte kërkesën për përjashtim.

**28.1.1.** Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Para fillimit të seancës gjyqësore znj. A .K. dhe avokati i saj kanë kërkuar përjashtimin e gjyqtarit (subjektit Florjan Kalaja) me një kërkesë të paraqitur në sekretari dhe jo në seancë dhe vetëm gjatë seancës i bëhet me dije ky fakt. Duke menduar se kjo ka qenë përpjekje e radhës e ankueses A.K. për të bllokuar gjykimin (pasi kjo gjë ishte tentuar dhe herë të tjera me kërkesa të tjera të ngjashme të mëparshme), largimi nga seanca pa e ndërprerë atë ka qenë për të mos shtyrë gjykimin dhe për të konfirmuar në sekretari nëse vërtet ishte depozituar kërkesë për përjashtim, që në fakt njoftimi i kërkesës për përjashtim ku nga vetë inspektorët është evidentuar që njoftimi duhej bërë nga kryetari i gjykatës dhe nga kancelarja. Kodi i procedurës nuk e njeh ndërprerjen e gjykimit si institut”.*

**28.1.2.** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse. Nenet 125 dhe 118 të Kodit të Procedurës Civile nuk përcaktojnë shprehimisht nëse *“ndërprerja e seancës nga subjekti i rivlerësimit për t'u njohur me kërkesë për përjashtim në sekretari”*, përbën shkelje nga ana e gjyqtarit të çështjes. Vërehet se për ekonomi gjyqësore gjyqtari ka vepruar pa marrë vendim për shtyrje seance dhe, sakaq, pasi është njohur me këtë kërkesë ka caktuar seancën e radhës.

**Komisioni vlerëson se në këtë ankesë nuk konstatohen elementë që ngarkojnë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit që mund të çojnë në një vlerësim negativ për sa i përket kriterit profesional.**

**28.2. Ankesa e subjektit S.H., (kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë),** e vitit 2016, ku pas verifikimit të saj nga Inspektorati pranë KLD-ja, subjektit Florjan Kalaja është dhënë *“tërheqje vëmendje”* për mungesë të pajustificuar në punë nga ana e subjektit ka shkelje të disiplinës që sipas germës “b” të pikës 4, të nenit 32, të ligjit 9877, datë 18.2.2008, konsiderohet si shkelje e lehtë. Në përfundim është çmuar se shkelja nuk është e tillë që të iniciohet procedim disiplinor ndaj subjektit dhe, për rrjedhojë, është çmuar tërheqja e vëmendjes me shkrim.

**28.2.1.** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore ka shpjeguar, ndër të tjera, se kundër këtij veprimi administrativ të kryeinspektorit ka ngritur padi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë e cila me vendimin e saj nr. \*\*\*, datë 10.2.2020, ndër të tjera, ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të padisë. Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ në trajtën e shkresës nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2016, të Kryeinspektorit të KLD-së drejtuar Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”.*

**Komision vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur prova të plota në lidhje me këtë ankesë duke mos u kualifikuar si shkelje për sa i përket kriterit profesional.**

**28.3. Ankesa e shtetasit Th.P.,** e vitit 2015, ku pas verifikimit të kësaj ankese nga Inspektorati pranë KLD-së është dërguar *“tërheqje vëmendje”* me shkrim për arsye se gjykimi i çështjes është realizuar në kapërcim të dukshëm të standardit kohor të gjykimit të përcaktuar në vendimin e KLD-së nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, *“Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, por këto shkelje nuk janë të mjaftueshme për të iniciuar në mënyrë të përshtatshme një procedim disiplinor, për këtë i tërhiqet vëmendje me shkrim.*

**28.3.1.** Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe në seancën dëgjimore ka shpjeguar se në relacionin e Kryeinspektorit është evidentuar se është shkelur afati i arsyeshëm i përfundimit të

gjykimit pasi gjykimi i kësaj çështjeje është vlerësuar nga vetë Kryeinspektori relativisht kompleks dhe po ashtu është konkluduar se shkaqet e shtyrjes së 11 seancave kanë qenë të justifikuar.

**28.3.2.** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse. Vërejtja me shkrim “*tërheqje vëmendje*” nga ana e Kryeinspektorit nuk qëndron për sa kohë që nga ky institucion është vlerësuar se ka pasur shkaqe të justifikueshme në zgjatjen e gjykimit.

**Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me këtë problematikë duke mos u ngarkuar me përgjegjësi që mund të çojnë në një vlerësim negativ në lidhje me kriterin profesional.**

**28.4. Ankesa e shtetases T.RR.,** e vitit 2015, e cila ngre pretendime ndaj vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit duke i rrëzuar padinë. Inspektorati pranë KLD-së ka konstatuar se pretendimet e saj nuk janë objekt i veprimtarisë së tij, pasi kanë janë fakte që zgjidhen në rrugë gjyqësore.

**28.4.1.** Komisioni ka vijuar, më tej, verifikimet nëpërmjet faqes zyrtare [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al), ku rezulton se nga Gjykata e Shkallës së Parë, në vendim e dhënë nga subjekti nr. \*\*\*, datë 30.1.2014, është vendosur “*rrëzimi i padisë*”. Pas ankimit të shtetases T.Rr., Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.6.2017, ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.9.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues*”, për mosrespektim të normave procedurale që lidhen me legjitimitetin e palëve në gjykim, moszgjidhjen e kërtimeve kryesore dhe formimin e rregullt të ndërgjyqësisë.

**28.4.2.** Komisioni vëren se nga Gjykata e Apelit Vlorë është evidentuar se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë: (i) nuk janë respektuar normat procedurale që lidhen me legjitimitetin e palëve në kërkim; (ii) gjykata ka anashkaluar bazën ligjore të padisë dispozitat e ligjit nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke iu referuar vetëm dispozitave të ligjit nr. 8510/1999, “Për përgjegjësitë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”; (iii) Gjykata e Shkallës së Parë ka zbatuar gabim ligjin nr. 8510/1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”; (iv) ka qenë e detyrueshme që në gjykim të thirrej në cilësinë e personit të tretë edhe Spitali Rajonal Vlorë.

**28.4.3.** Në lidhje me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar se:

*i) në lidhje me legjitimitetin e palëve, i është shpjeguar ankueses T.Rr., se bazuar në L.8510/1999 për përgjegjësinë jashtëkontraktore duhet të mbajë parasysh çështjen e zëvendësimit procedural, por nga ana e ankueses është deklaruar se do vijojë me këtë situatë që është tani. Pra, kjo që është sugjeruar nga subjekti si veprim që duhej bërë nga pala në gjykim, dhe sot Gjykata e Apelit e ka konsideruar këtë si shkelje;*

*ii) në lidhje me anashkalimin e bazës ligjore, nga Gjykata e Apelit është thënë se nuk është marrë parasysh baza ligjore që paditësja ka vënë në padi. Subjekti ka sqaruar se në vendimin unifikues nr. 3, i vitit 2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë përcaktohet: “Gjykata nuk mund të lidhet kurrësi me propozimin e bazës ligjore që bëjnë palët pasi...gjykata është e pavarur në mënyrën si e vlerëson se mbi bazën e kujt dispozite çështja duhet të zgjidhet”;*

*iii) në lidhje me përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore, subjekti shpjegon se nga gjykata e apelit është thënë që në rastin konkret nuk mund të zbatohet ligji për përgjegjësinë jashtëkontraktore të administratës publike, por do duhet të zbatohet ligji për mbrojtjen nga diskriminimi. Ndërkohë që në këtë çështje, fakti i paligjshëm është tashmë i*

konstatuar, sepse kemi një vendim të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që ka konstatuar se zgjidhja e kontratës të punës së ankueses është bërë në mënyrë të paligjshme duke e diskriminuar atë, që do të thotë se gjykatës në këtë moment nuk i duhet më ligji për diskriminimin, por i duhet ligji kush mban përgjegjësi, mban personalisht drejtori i spitalit apo mban institucioni dhe institucioni me padi regresi pastaj mund të kthejë, mund t'i kërkojë drejtorit të spitalit çdo gjë që ka dhënë në mënyrë të paligjshme për të;

iv) në lidhje me thirrjen e personit të tretë në gjykim Spitali Rajonal Vlorë subjekti shpjegon se vendimi është dhënë para se të hyjnë në fuqi ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile, që do të thotë është interpretuar germa “d”, e nenit 467, që thoshte më përpara: “Gjykata e Apelit prish vendimin, kthen çështjen për rigjykim kur nuk është formuar në rregull ndërgjyqësia.” Sot kjo dispozitë, ka ndryshuar dhe ka përmbyllur mundësinë e abuzimit të gjykatave të apelit me germën “d” të nenit 467 të Kodit të Procedurës Civile që vendosi riformulimin si vijon: Gjykata e Apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë tërësisht apo pjesërisht sipas kufijve të nenit 121 të këtij Kodi dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur: d) nuk është formuar drejt ndërgjyqësia sipas nenit 162, paragrafi i dytë i këtij Kodi”. Ndërkohë që paragrafi i dytë i nenit 162 të Kodit të Procedurës Civile rregullim cili parashikon situatën e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme në procesin gjyqësor civil dhe administrativ ku sanksionohet se: “Kur për shkak të natyrës së marrëdhënies juridike që janë në konflikt ose për shkak të një dispozite ligjore, efekti i vendimit që do të jepet, shtrihet në të gjithë bashkëndërgjyqësit, veprimet procedurale që janë kryer prej disa bashkëndërgjyqësve kanë efekt për bashkëndërgjyqësit e tjerë që nuk janë paraqitur në gjykatë ose që nuk kanë kryer ndonjë veprim në afatin e caktuar. Ndryshimi i nenit 467 i Kodit të Procedurës Civile ka pasur si qëllim të ndalonte një herë e mirë vendimet e paligjshme të prishjes dhe kthimit për rigjykim të gjykatave të apelit duke i treguar se formimi i rregullt i ndërgjyqësisë është një prezumim procedural për vlefshmërinë e procesit vetëm për mosformimin e bashkëndërgjyqësisë së detyrueshme dhe kurrë për mosformimin e ndërgjyqësisë dytësore të personave të tretë.

Pikërisht të kundërtën e parashikimit ligjor ka bërë në këtë rast Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin e datës 3.6.2017, pasi ka prishur vendimin ka konkluduar se gjykata e shkallës së parë ka shkelur rregullat për formimin e ndërgjyqësisë dytësore me arsyetimin se subjekti duhet të kishte vendosur thirrjen me cilësinë e personit të tretë të Spitalit Rajonal Vlorë dhe kjo do të thotë se germa “d”, e nenit 467, të Kodit të Procedurës Civile është zbatuar gabim nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe se vendimi i prishjes dhe kthimit për rigjykim është i paligjshëm. I mbetet Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë të japë përfundimisht përgjigje pasi të disponojë mbi rekursin e palës së paditur”.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme ku në arsyetimin e vendimit është udhëhequr nga praktika të konsoliduara të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë të referuara në shpjegimet e tij, gjithashtu është udhëhequr nga bindja e brendshme e tij në mënyrën e dhënies dhe arsyetimit të vendimit.**

**28.5. Ankesa e bërë nga A., së Sh..., e vitit 2016, i referohet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nr. \*\*\*, datë 7.2.2016, që ka vendosur: “Kthimin e kërkesë padisë si me të meta. Në lidhje me këtë vendim A..., paraqet këtë kundërshtim: “Vendimarrja e gjykatës është bërë në kundërshtim me nenin 297 të Kodit të Procedurës Civile i cili shprehimisht thekson: “Gjykata vendos pezullimin e gjykimin kur: c) njëra palë vdes, ose mbaron personi juridik.**

Pas ankimit të A..., së Sh..., Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.7.2017, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 7.2.2016, dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimin. Çështja aktualisht ndodhet në Gjykatën e Lartë pas rekursit të palës së paditur”.

**28.5.1.** Inspektorati i KLD-së ka konstatuar se vendimi nr. \*\*\*, datë 7.2.2016, i gjyqtarit Florjan Kalaja për “kthimin e kërkesë padisë si me të meta” është dhënë në kundërshtim me nenin 297 të Kodit të Procedurës Civile. Subjekti Florjan Kalaja duhej të kishte vendosur pezullimin e çështjes në rastin konkret dhe jo kthimin e akteve.

**28.5.2.** Komisioni ka administruar vendimin nr. \*\*\*, datë 12.2.2017, të Gjykatës së Apelit Vlorë, ku është arsyetuar se: (i) Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur kthimin e padisë në kundërshtim me kërkesat e neneve 154 dhe 154/a të Kodit të Procedurës Civile pa mbajtur në konsideratë rrethanat e sipërcituara; (ii) identifikimi i bashkëpronarëve të pasurisë mund të bëhet vetëm pas regjistrimit të vdekjes së të paditurit në gjendjen civile dhe ndjekjen më pas të procedurave për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së tij; (iii) është detyrë e gjykatës të garantojë zhvillimin e procesit dhe të urdhërojë paraqitjen e akteve nga personat e tretë ose palët në gjykim që mbajnë qëndrim pasiv me gjithë kërkimet e palës ndërgjyqëse; (iv) në këto kushte, në rigjykim gjykata duhet t’i lërë si detyrë të dyja palëve paraqitjen e certifikatës së vdekjes së shtetasit Th.D., nga zyra e gjendjes civile dhe pasi të bëhet regjistrimi i këtij fakti të kërkojë nga palët paraqitjen e dëshmisë së trashëgimisë për këtë trashëgimlënës duke i dhënë kohën e nevojshme.

**28.5.3.** Në lidhje me këto konkluzione të Gjykatës së Apelit, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore ka shpjeguar se pala kishte vdekur në korrik të vitit 2007 dhe padia ngrihet diku nga viti 2014, 2015 dhe në seancë subjekti ka konstatuar që pala ka vdekur në vitin 2007, para se padia të ngrihet.

Inspektori, Avokatura e Shtetit dhe Gjykata e Apelit Vlorë janë shprehur se, për sa kohë kjo palë rezulton i gjallë në gjendjen civile shqiptare, prezumohet i gjallë, pavarësisht se mund të ketë vdekur në vitin 2007, në Principatën e Monaco-s. Nga subjekti është refuzuar ta pranojë këtë lloj mënyre prezumimi sepse: *“Ka një prezumim në Shqipëri, jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë ligjet civile të shteteve normale, është prezumimi i vdekjes për të zhbllokuar të mirat materiale, jo prezumimi i gjalljes për t’i bllokuar të mirat materiale në qarkullimin civil”*. Kështu nga subjekti është sqaruar se: *“Në vendim, te pjesa, te shkaku i vendimmarrjes kam thënë që neni 297/c i Kodit të Procedurës Civile, është e vërtetë që neni 297, germa “c”, thotë që kur pala vdes, jo kur pala ka vdekur para procesit, sepse unë nuk mund të pranoj që mund të paditen të vdekurit, me idenë që gjykata do ta pezullojë gjykimin, do t’i lërë palës paditëse kohë për të ndrequr të metat”*. Në këtë rast, padia është me të meta dhe prandaj prej subjektit janë konstatuar të metat. Avokaturës së Shtetit i janë lënë 2 seanca kohë për të ndrequr të metat, sepse është në detyrimin e palës paditëse të identifikojë të paditurin dhe në momentin që pas dy seancash Avokatura e Shtetit ka këmbëngulur të vazhdojë me germën “c”, të nenit 297, pra, të gjykojë të vdekurit në prezumimin që Zyra e Gjendjes Civile Shqiptare e rezulton të gjallë atë shtetasin që ka vdekur në vitin 2007. Subjekti ka vendosur kthimin e akteve sepse i vdekuri nuk mund të paditet.

**Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme duke mos u ngarkuar kështu me përgjegjësi disiplinore që mund të çojnë në një vlerësim negativ të subjekti në lidhje me kriterin profesional.**

**28.6. Ankesa e shtetasit A.K.,** e vitit 2018, ku pas verifikimit të kësaj ankese nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë deklaroi se meqë subjekti Florjan Kalaja ushtron detyrën si ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë, inspektorati çmon se këto pretendime dalin tej kompetencave të tij verifikuese dhe pretendimet do të verifikohen.

**28.6.1.** Komisioni, pasi ka administruar vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, ka bërë një analizë të tij.



**Komisioni vëren se ankesa e shtetasës A.K., ka të bëjë me themelin e çështjes dhe jo me anën procedurale të zbatuar nga subjekti Florjan Kalaja, për të cilën Komisioni mban parasysh nenin 72<sup>55</sup> të ligjit nr. 96/2016.**

**28.7. Ankesa e shtetasit P.G., e vitit 2016,** ku pas verifikimit të kësaj ankese nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë konstaton se pretendimet e saj nuk janë objekt i veprimtarisë së tij, pasi kanë fakte që zgjidhen në rrugë gjyqësore mbi bazën e ankimit të vendimit prej palëve ndërgjyqëse. Është konkluduar se nuk ka vend për verifikimin e ankesës dhe ajo është arkivuar.

**28.7.1.** Komisioni, pavarësisht konkluzionit të Inspektoratit të KLD-së ka administruar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>56</sup> të çështjes civile ku P.G., është në cilësinë e të paditurit/kundërpaditës dhe kërkon anulimin e vendimit të ish KKKP-së Vlorë etj..., ku gjykata në përfundim të gjykimit ka vendosur rrëzimin e kundërpadisë së ngritur nga P.G., dhe të tjerë. Kjo çështje ende nuk është gjykuar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

**Komisioni vëren se ankesa e shtetasit P.G., është objekt gjykimi i gjykatave të shkallëve më të larta për të cilat Komisioni mban parasysh nenin 72<sup>57</sup> të ligjit nr. 96/2016**

## **TË DHËNA BURIMORE NGA PROKURORITË**

**29.** Prokuroria e Përgjithshme<sup>58</sup> ka vënë në dispozicion të Komisionit informacionin e përcjellë nga prokuroritë e rretheve gjyqësore.

**29.1.** Prokuroria e Përgjithshme – Sektori i Protokollit dhe Arkivit<sup>59</sup> konfirmon se ndaj subjektit Florjan Kalaja nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj tij. Gjithashtu, rezulton se për periudhën 2006 – 2020, janë regjistruar praktikat e ankesave të shtetasve M.M., dhe F.P., (të dy ankesat janë të vitit 2018).

**29.1.1.** Komisioni vëren se ankesa e shtetasit M.M., është e njëjtë me denoncimin e bërë prej tij, denoncim i cili është trajtuar nga Komisioni në rubrikën e denoncimeve, ndërsa ankesa e shtetasit F.P., nuk identifikon qartë problematikën dhe lidhjen me subjektin Florjan Kalaja, pasi emri i tij nuk përmendet në ankesën e shtetasës. Përveç ankesës, nuk ka të bashkëngjitur dokumentacion tjetër.

**29.2.** Prokuroria e Përgjithshme - Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit<sup>60</sup> konfirmon se nuk rezulton që të ketë ankesa për subjektin Florjan Kalaja.

**29.3.** Prokuroritë e rretheve<sup>61</sup> kanë konfirmuar se nuk kanë të regjistruara procedime penale dhe nuk disponohet të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme për subjektin e rivlerësimit, z. Florjan Kalaja.

---

<sup>55</sup> Neni 72, pika 4: Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

<sup>56</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me rrugë elektronike (e-mail, datë 16.10.2020) ka dërguar vendimin nr. \*\*\*, datë 1.11.2016, të kërkuar nga Komisioni.

<sup>57</sup> Neni 72, pika 4: Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

<sup>58</sup> Prokuroria e Përgjithshme nr. \*\*\* prot, datë 11.11.2020.

<sup>59</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot, datë 2.9.2020.

<sup>60</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.8.2020.

<sup>61</sup> Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor: Pogradec nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2020; Vlorë nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2020; Shkodër nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2020; Kurbin nr. \*\*\* prot., datë 3.9.2020; Mat nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2020; Berat

**29.4.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier<sup>62</sup> konfirmon se ndaj subjektit Florjan Kalaja në datën 30.7.2014 është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, për të cilin në datën 16.11.2014 është vendosur mosfillim i procedimit penal. Komisioni vëren se kallëzimi është bërë nga shtetasi RR.D., ndaj subjektit Florjan Kalaja për veprën penale të “shpërdorimit të detyrës”. Nga Prokuroria e Rrethit Fier janë bërë verifikimet dhe është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Nuk ka të dhëna nëse ndaj vendimit të mosfillimit është bërë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

## **DENONCIME NGA PUBLIKU**

### **30. Ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, janë depozituar 4 denoncime nga publiku.**

#### **30.1. Në lidhje me denoncimet:**

i) Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 5.4.2018, i shtetasit A.H., i cili ngre pretendime për korrupsion për një vendim të padrejtë të dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

ii) Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2018, i shtetasit S.V., i cili kërkon nga Komisioni që testamenti objekt gjykimi të konsiderohet i pavlefshëm pasi janë shkelur normat e Kodit Civil, pasi ky testament është konsideruar i vlefshëm nga subjekti i rivlerësimit.

iii) Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 29.1.2019, i shtetasit M.M., i cili ankohet për vendim të padrejtë dhënë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe vendim të padrejtë dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë që ka lënë në fuqi vendimin e dhënë nga subjekti.

**30.1.1.** Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrupsion, korrektësinë e vendimeve dhe me themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk provohen dhe nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016.

**Komisioni, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerëson se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.**

**30.2.** Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2017, i shtetasit V.M., i cili ankohet për vendim të padrejtë të subjektit të rivlerësimit në çështjen me objekt “rivendosjen në afat të së drejtës së

---

nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2020; Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2020; Krujë nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2020; Përmet nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2020; Gjirokastrë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020; Korçë nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2020; Lezhë nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2020; Dibër nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2020; Vlorë nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2020; Durrës nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2020; Sarandë nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020; Lushnje nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2020; Kavajë nr. \*\*\* prot., datë 27.8.2020; Kukës nr. \*\*\* prot., datë 25.8.2020; Elbasan nr. \*\*\* prot., datë 24.8.2020; Tropojë nr. \*\*\* prot., datë 20.8.2020; Pukë nr. \*\*\* prot., datë 12.8.2020; Korçë nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2020; Prokuroritë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2020; pranë Gjykatës së Apelit Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 3.9.2020; pranë Gjykatës së Apelit Durrës nr. \*\*\* prot., datë 10.9.2020; pranë Gjykatës së Apelit Vlorë nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2020; pranë Gjykatës së Apelit Shkodër nr. \*\*\* prot., datë 13.8.2020; Gjykata e Apelit Durrës nr. \*\*\* prot., datë 4.9.2020; Gjykata e Apelit Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2020.

<sup>62</sup> Prokuroria e Rrethit Fier me nr. \*\*\* prot., datë 3.9.2020.

ankimit kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me nr. \*\*\*, datë 8.7.2011”, vendim ky që nga Gjykata e Apelit Vlorë është ndryshuar, duke u pranuar padia e denoncuesit.

**30.2.1.** Komisioni ka administruar dokumentacionin e kësaj çështje nga Gjykata e Rrethit Vlorë dhe Gjykata e Lartë<sup>63</sup>. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.10.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës së V.M. si e pabazuar në ligj*”.

Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 16.10.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Pranimin e kërkesën për rivendosjen në afat të kërkesës së kërkuarit V.M., në të drejtën e ankimit, kundër vendimit gjyqësor civil nr. \*\*\*, datë 807.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*”.

**30.2.2.** Komisioni ka konstatuar se Gjykata e Apelit Vlorë në vendim ka arsyetuar se: **(a)** vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është marrë në zbatim të gabuar të normave procedurale; **(b)** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në vendimin e çështjes së themelit në seancën përgatitore të datës 4.5.2011 në verifikimin e paraqitjes së palëve, i ka rezultuar që i padituri nuk ka marrë dijeni për shkak se në fletëthirrje rezulton shënimi “adresa e pasaktë”. Gjykata në vend që t’i caktonte paditësve afat për plotësimin e të metave, përcaktimin e adresës së saktë të të paditurit në përputhje me nenin 154 të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur të procedojë me shpallje në kundërshtim me kushtet e vendosura në nenin 133 të Kodit të Procedurës Civile. Në vijim, në kundërshtim me mënyrën e njoftimit të vendosur në seancë dhe përcaktuar në procesverbal, në dosjen gjyqësore ndodhet një fletëthirrje për njoftimin e seancës në datën 4.5.2011. Nga fletëthirrja nuk rezulton asnjë shënim, pra, njoftimi nuk i është nisur fare të paditurit dhe, për rrjedhojë, për seancën e datës 25.5.2011 i padituri nuk ka marrë njoftim, madje në verifikimin e paraqitjes së palëve theksohet vetëm që nuk u paraqit i padituri pa pasqyruar mënyrën e njoftimit të tij dhe faktin nëse ka marrë ose jo dijeni.

**30.2.3.** Komisioni vëren se në vendimin e dhënë nga subjekti nuk janë dhënë shpjegime të qarta në lidhje me arsyet e rrëzimit të kërkesës për rivendosje në afat të të drejtës së ankimit dhe për këtë arsye i ka kërkuar shpjegime.

**30.2.4.** Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se neni 458 i Kodit të Procedurës Civile nuk mund të shërbejë si mjet ankimi për të rihapur proceset gjyqësore të përfunduara me vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk mund të shërbejë si mjet ankimi që t’i japë gjykatës së shkallës së parë juridiksion rishikues pasi kjo vjen në kundërshtim me nenin 43 dhe 135 të Kushtetutës. Në rastin konkret pala kërkuese ka pretenduar si shkak për rivendosjen në afatin e ankimit pavlefshmërinë në aktet procedurale të njoftimit, të realizuara në gjykimin e themelit nga ana e gjykatës së shkallës së parë që kanë shërbyer për marrjen e vendimit të gjykimit në mungesë të V.M. Ndërkohë neni 458 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: “*Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat përpara gjykatës që ka dhënë vendimin. Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata dhe kundër vendimit të tij mund të bëhet ankim i veçantë*”. Subjekti ka referuar dhe Vendimin nr. \*\*\*, datë 27.1.2005, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku, ndër të tjera, citohet: “*Pavlefshmëria e njoftimeve nuk ka të bëjë me shkaqet e arsyeshme që parashikon neni 458 dhe që lejojnë rivendosjen në afat të ankimit, prandaj gjykata që shqyrtonte kërkesën sipas nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të bënte gjë tjetër vetëm të rrëzonte atë si të pabazuar*”.

---

<sup>63</sup> Gjykata e Rrethit Vlorë me nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2020; Gjykata e Lartë me nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2020.

**30.2.5.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota dhe bindëse në lidhje me këtë ankesë. Dispozita 458 e Kodit të Procedurës Civile ka përcaktuar që kërkesa për rivendosje në afat kur palët e kanë humbur afatin e ankimit mund të ngrihet për shkaqe të arsyeshme duke përjashtuar pavlefshmërinë e njoftimeve. Gjithashtu, referuar vendimeve të Kolegjeve Civile të Gjykatës së Lartë, përcaktohet si vijon: *“Pavlefshmëria e njoftimeve nuk ka të bëjë me shkaqet e arsyeshme që parashikon neni 458 dhe që lejojnë rivendosjen në afat të ankimit, prandaj gjykata që shqyrtonte kërkesën sipas nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të bënte gjë tjetër vetëm të rrëzonte atë si të pabazuar”*.<sup>64</sup>

**Komisioni vlerëson se denoncimi i bërë nga ankuesi V.M., nuk mund të kualifikohet si shkelje që do të çonte në një vlerësim negativ të subjekti të rivlerësimit për sa i përket kriterit profesional**

### **VLERËSIMI I ÇËSHTJES NGA TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

Trupi gjykues, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Florjan Kalaja:

a. Ka kryer deklarin të mjaftueshëm dhe në vlerësim tërësor, të saktë të pasurisë, duke u konstatuar pasaktësi të karakterit minimal.

Nga analiza financiare për periudhën e deklaramit 2010 – 2016, për çdo vit deklarimi, rezultoi se me të ardhurat e fituara nga punësimi tij dhe i personit të lidhur me të, si dhe huat, ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme financiare për kryerjen e investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruara. Mungesa e burimeve të ligjshme financiare në shumën 590,198 lekë, për blerjen e mjetit tip “BMW”, në vitin 2015, në bazë të parimit të proporcionalitetit, si dhe marrë për bazë balancën financiare pozitive të subjektit për vitet 2014 dhe 2015, Komisioni e vlerëson se nuk përbën shkak të mjaftueshëm që mund të çojnë në konkluzionin se ndodhet përpara një deklarimi të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, në aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra referuar nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

b. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

c. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

Bazuar në këto konkluzione, si dhe nga vlerësimi tërësor i procedurave, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, nga vlerësimi i secilit prej të tria kriterëve:

▪ ka arritur nivel të besueshëm të pasurisë, duke përmbushur kushtet ligjore të germës “a”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016;

<sup>64</sup> Vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil nr. \*\*\*, datë 27.1.2015.

- ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas nenit 59/b, të ligjit nr. 84/2016;
- konsiderohet “i aftë”, në vlerësimin e aftësive profesionale duke përmbushur kushtet ligjore të germës “c”, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, dhe në bazë të pikës 1/a, të nenit 58 dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Florjan Kalaja, gjyqtar i komanduar në Gjykatën e Apelit Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 17.12.2020.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Xhensila PINE**  
Kryesuese

**Olsi KOMICI**  
Relator

**Firdes SHULI**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*